



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Mesuesi për Arsimin Parashkollor”

ofruar nga

Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Gezim Dibra

Prof.As. Nada Kallçiu

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ Mësuesi për Arsimin Parashkollor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.369 datë 10.07.1995
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 69, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023 18 PAE / 4 PAK; Viti akademik 2023-2024 18 PAE / 5 PAK; Viti akademik 2024-2025 18 PAE / 4 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 13 studentë; Viti akademik 2023-2024 15 studentë; Viti akademik 2024-2025 14 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesore, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit "Fan S.Noli" të Korçës (në vijim UNIKO) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UNIKO. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Programi i studimit është hapur me VKM Nr.369, date 10.07.1995 *licensuar si program i ciklit të parë " Bachelor"*. Programi ofrohet prej Departamenti i Edukimit (DE) në UNIKO.

Aktualisht, programi Bachelor në: "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" si program i ciklit të parë të studimeve universitare synon të formojë edukatorë apo mësues për arsimin parashkollor. Ai përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike / 6 semestra. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Diplomë Bachelor "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Forma e regjistrimit të diplomës: Urdhër i QSHA nr.69, datë 15.03.2022

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vite është:

- Për vitin akademik 2024-2025 është 14 studentë
- Për vitin akademik 2023-2024 është 15 studentë
- Për vitin akademik 2022-2023 është 13 studentë

Gjithsej studentë. 42 studente

Të diplomuar

Viti akademik 2021-2022 10 studente

Viti akademik 2022-2023 13 studente

Viti akademik 2023-2024 6 studente

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" nuk ka kaluar më parë proces akreditimi. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Mësues për Arsimin Parashkollor. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga **Prof. Dr Gëzim Dibra** dhe **Prof. Asoc. Nada Kallçiu** dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli. Vizitat u realizuan në datat 5 dhe 6 Mars 2025. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASCAL.

Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, të UNIKO-së, është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 5 datë 07.01.1992 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Korçës “Fan S. Noli”
- VKM Nr.369, date 10.07.1995, për licencimin e Programit Bachelor “Mësues për Arsimin Parashkollor” si program i ciklit të parë i studimeve bachelor në Universitetin “Fan S.Noli” Korçë.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UNIKO-s dhe Rregulloret në UNIKO.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambjentet e brendshme të UNIKO-s dhe në Fakultetin të Edukimit dhe Filologjisë -së.

Analiza e të dhënave parësore është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor “Mësuesi për Arsimin Parashkollor (Janar 2025), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Drejtues te institucionit që mbulojne programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Ëeb site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe të Kërkimit shkencor.
- Takim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; Koordinatorin e projekteve Erasmus +.
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizmi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

Vëzhgimi i mjediseve mësimore në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të arteve, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FEF-së dhe të UNIKO-së. Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.05.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/56 Prot, datë 12.05.2025. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, njofton në ASCAL në datë 23.05.2025, nëpërmjet shkresës me Nr. 1055/1, Prot, datë 21.05.2025, "Dërgohen komentet për draft raportet e vlerësimit të jashtëm Bachelor në mësuesi në arsim parashkollor dhe Bsc në mësuesi në arsim fillor, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga UNIKO evidentohet se Programi i Studimit Bachelor “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje dhe përshtatje me interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe me qëllimet kombëtare, dhe detyrimeve që përcaktohen në Ligjin nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe aktet e tij nenligjore. Programi i studimit synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin parashkollor, aftësimin dhe formimin e kompetencave për tu përgjegjur tregut të punës, duke kontribuar për komunitetin e zonës dhe më gjërë, etj. Ky program studimi në përputhje me objektivat e përcaktuara në strategjinë 2022-2027 të zhvillimit të institucionit synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare dhe përpiqet të pasurojë dhe të rrisë këto vlera si dhe synimet akademike të studentit nëpërmjet aktiviteteve që i promovojnë ato. ¹
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Konstatohet se, nga shqyrtimi i Statutit të institucionit si dhe i planit Strategjik të zhvillimit 2022-2027 të institucionit, programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike të dhe me misionin e institucionit, ² konkretizuar edhe në Rregulloren e Organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe shkencore të FEF dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve me kompetencave thelbësore, praktike funksionale, si edhe komunikuese me synim kryesor për të kontribuar në zhvillimin rajonal dhe më gjërë. ³
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullore së Institucionit	Konstatohet se Programi i studimit Bachelor “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike të UNIKO-së pasqyruar në statutin e tij. Evidentojmë se Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UNIKO dhe përgatit specialistë në fushën e arsimit parashkollor, duke kontribuar në

¹ “Plani strategjik i zhvillimit të Univeritetit 2022-2027”. Referuar evidencës nr. 1.3

² “Statuti i Universitetit të Korçës”. Referuar evidencës nr.1.1

³ “Rregullore e Organizimit dhe veprimtarisë mësimore e shkencore e FEF”. Referuar evidencës nr.1.5



si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	përgatitjen teoriko-praktike përmes lëndëve të përgjithshme dhe specifike, praktikave pasive e aktive në kopshte të këtyre mësuesve të ardhshëm. ⁴																					
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita dhe takimet në IAL evidentojmë se Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ofrohet nga departamenti i Edukimit, i cili është njësi bazë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë. Ky departament disponon përvojë të konsoliduar, kapacitete të nevojshme dhe burime të përshtatshme në fushën përkatëse akademike për realizimin e programit. ⁵. Departamenti i Edukimit për vitin akademik 2024 – 2025 ka në përbërje të tij, 12 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE), dhe 16 personel akademik me kontratë (PAK), me kualifikimet si më poshtë: <table><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>1</td><td>5</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr. në proces</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>8</td></tr><tr><td>Totali</td><td>12</td><td>16</td></tr></table> Konstatohet se Departamenti i Edukimit ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e këtij programi dhe përmbush kriteret sasiore dhe cilësore të stafit akademik, të mjaftueshme për zbatimin e efektshëm të programit. Vihet re qartë se stafi akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme kanë përgatitjen e përshtatshme akademike e shkencore, në përputhje me kërkesat e këtij programi studimi, si dhe ruhet dhe respektohet raporti i stafit akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme. ⁶	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	5	Prof. Asoc.	-	3	Dr./PhD	5	-	Dr. në proces	3	-	Msc.	3	8	Totali	12	16
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	1	5																				
Prof. Asoc.	-	3																				
Dr./PhD	5	-																				
Dr. në proces	3	-																				
Msc.	3	8																				
Totali	12	16																				
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit	Rezulton se Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, dhe strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë. Fushat e studimit të këtij programi bazohet në drejtimet e																					

⁴ “Statuti i Universitetit të Korçës”. Referuar evidencës nr.1.1; “Plani strategjik i zhvillimit të Univeritetit 2022-2027”. Referuar evidencës nr. 1.3

⁵ “Stafi Akademik I DE” Tabela përmbledhëse Aneks (Tabela 1; 2.)

⁶ “Jetshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit” Referuar evidencës nr.2.14

duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	kërkimit shkencor të UNIKO-s Rregullorja mësimore e programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ⁷ e ofruar nga Departamenti i Edukimit, mbështetet në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, si edhe në Udhëzimin e MASR nr.31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”. ⁸			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e gjetjeve në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL lidhur me kriteret për standardin I.1, vëren se programi Bachelor në “Mësuesi për arsimin parashkollor” është në përputhje me qëllimet dhe interesat kombëtare. Ky program ka një eksperiencë shumëvjeçare që zbatohet nga UNIKO dhe FEF dhe DE përgjegjëse për këtë program kanë kapacitete të kualifikura dhe të mjaftueshme për zbatimin e tij në mënyrë efektive.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se Departamenti i Edukimit lidhur me zbatimin e programit mësimor në Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi brenda fakultetit me departamente të tjera si me Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane, për të mundësuar realizimin efektiv të kompetencave që ka ky program studimi.

⁷ Rregullore e brendëshme e DE” Referuar evidencës nr. 2.4.

⁸ Udhëzimi i MASR nr.31 datë 29.12.2017

detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Realizimi i këtij bashkëpunimi është sanksionuar në Rregulloren e programit ⁹ dhe mbarëvajtja dhe rezultatet pasqyrohen në analizën vjetore të DE dhe FEF-së ¹⁰
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Konstatohet se Departamenti i Edukimit ka marrëdhënie të mira bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit me institucione, si: Departamenti i shkencave të edukimit të Universitetit të Bolonjës, Programi TEAVET për mësimdhënien, ZVA dhe Bashkisë Korçë ¹¹ . Pozitive është praktika e përdorur nga DE dhe FEF për të analizuar dhe përgatitjes së raporteve për përfitimet e programeve nga ky bashkëpunim, si dhe mundësinë e ndryshimeve që mund të bëhen. ¹²
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatese për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura nga institucioni evidentohet se IAL ka mbi 50 marrëveshje të nënshkruara me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si Akademia e Shkencave, Ministrinë, Axsens shtetërore dhe Institucione kërkimore të gjitha në shërbim të realizimit të programeve të studimit. ¹³ Rezulton se FEF ka nënshkruar marrëveshje të posaçme, bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale me Bashkinë Korçë, Devoll, Kolonjë, Pogradec etj. si dhe me Drejtorinë Rajonale Arsimore Korçë. ¹⁴
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njëria përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga bisedat me stafin dhe me studentët evidentohet se praktikantët udhëhiqen nga pedagogu mentor, në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe më pas realizohet edhe një analizë lidhur me këto praktika si në analizën vjetore të fakultetit dhe departamentit. ¹⁵ <i>Sugjerohet se duhet të ketë edhe një program lënde për praktikën profesionale i cili të hartohet nga pedagogët udhëheqës të kësaj praktike.</i>

⁹ "Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" Evidenca nr.2.4

¹⁰ "Analizë e punës mësimore shkencore e DE dhe FEF-së. Evidenca nr. 2.9 dhe 2.10

¹¹ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve ndërkombëtare" Evidenca Nr.3.10 ; "Tabela përmbledhëse për anekset" (tabela nr.5)

¹² "Procesverbal i DE për ecurinë e programeve të studimit" Evidenca nr. 3.9

¹³ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve ndërkombëtare" Evidenca Nr.3.10; "Tabela përmbledhëse për anekset" (tabela nr.5)

¹⁴ "Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të praktikës profesionale".Evidenca nr.3.12

¹⁵ "Raport i analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE" Evidenca nr.2.10

Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se Departamenti që mbulon programin ka krijuar një kulturë bashkëpunimi me instituente dhe projekte që mbështesin formimin akademik dhe praktik të studentëve. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Rregulloret e Institucionit, njësisë kryesore dhe të organeve të tjera rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave brenda institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të	Rezulton se Programi i studimit Bachelor në “Mësues për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në mënyrë të veçantë me Ligjin 80/2015 si dhe aktet e tjera ligjore si Udhëzim nr.31, datë. 29.12.2017 për Riorganizimin e Programeve të Studimit¹⁶ dhe me orientimet e Kartës së Bolonjës. Ky program zbatohet konform Rregullores së Programit të Studimit¹⁷ dhe është i organizuar në lëndë dhe module, të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor, ku krahas tyre jepen në mënyrë të hollësishme edhe kreditet përkatëse sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)¹⁸ por dhe të

¹⁶ MARS Udhëzim nr.31, datë. 29.12.2017 për Riorganizimin e Programeve të Studimit.

¹⁷ “Rregullore e programit të studimit. Evidenca nr. 2.4

¹⁸ “Plani mësimor i programit bachelor në “Mësuesi për arsimin parashkollor” Evidenca nr. 2.5

Krediteve (ECTS).	dhëna të tjera mbi tipologjinë e lëndës, semestrin apo vitin akademik kur mund të frekuentohet, ngarkesën semestrale etj
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ka si objektiv kryesor përgatitjen e mësuesve për edukimin parashkollor dhe paisjen e studentëve me Diplomën Bachelor. Programi synon një kualifikim teorik dhe praktik të studentëve të tij në fushën e mësimdhënies. Ai gjithashtu synon të japë kontribut për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ngritjes së standardeve të mësuesit të arsimit parashkollor duke bashkëpunuar dhe ndihmuar institucionet e kopshteve që ushtrojnë veprimtari në këtë hallkë të arsimit të nxënësve.¹⁹ Nga analiza e planit mësimor të programit dhe syllabuseve rezulton se njohuritë e fituara nga kurset e ndryshme të këtij programi i mundësojnë studentëve të pajisjen me kompetenca e aftësi profesionale në fushat kryesore, të cilat në fund të studimeve i lejojnë studentët, të bëhen specialistë të aftë në këtë profil²⁰. <i>Duke bërë një vëzhgim të thelluar të lëndëve të kurrikulës mendojmë se disa lëndë kanë koncepte apo ofrojnë tema që nuk përputhen me emërtimin (Njohuri kompjuteri në moshë të vogël në AP dhe Mësimdhënia dhe të Nxënësve nëpërmjet teknologjisë në AF) apo janë mbi nivelin e arsimit parashkollor.</i> <i>Ndaj GVI rekomandon që të disa nga lëndët që janë të përbashkëta me arsimin fillor të jenë më të thelluara me mësimdhënien në kopshte dhe nivelin parashkollor.²¹</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga analiza e programit të studimi rezulton se kurrikula është në përputhje me kërkesat ligjore të ndërtimit të planit mësimor. Përkatesisht, ndarja e krediteve sipas kategorive respektive është si më poshtë: - Kategoria A që përfshin Lëndët Bazë 34 kredite ose 18.9 % të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve %-20%; - Kategoria B që përfshin Lëndët Karakterizuese 97 kredite ose 53.8 % të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 50%-55%; - Kategoria C që përfshin Lëndët Ndërdisciplinore /Integruese 22 kredite ose 12. 2% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 12%-15%; - Kategoria D që përfshin Lëndët Plotësuese 21 kredite ose

¹⁹ “Rregullore e programit të studimit AP”.Evidenca nr.2.4

²⁰ “ Plan i mësimorë i programit”.Evidenca nr.2.6

²¹ “ Programet lëndore model syllabusi 2024-2027” Evidenca nr.2.12

	11.7.% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 10%-15%; - Kategoria E që përfshin <i>Detyrimet Përmblylëse</i> 6 kredite ose 3.3% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 3%-5%; Konstatohet se kurrikula e këtij programi është hartuar duke mbajtur parasysh që çdo lëndë/modul të zërë vendin që i takon në kuadër të veprimtarive formuese^{22/23}
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit kurrikulës të Programit të studimit evidentohet se ai ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, e cila ka një peshë specifike prej 7 ECTS. 175 orëve. Studentët dërgohen pranë institucioneve arsimore, të përzgjedhura dhe të përcaktuara nga marrëveshjet e nënshkruara mes institucionit UNIKO me ZVA Korçë dhe me Bashkinë Korçë, Devoll, Pogradec etj, <i>por nuk ka një program që hartohet nga pedagogët udhëheqës</i>. Rezulton se studentët ndjekin praktikën përgjatë semestrit të VI në institucione të ndryshme arsimore të sektorit publik ku edhe vlerësohen nga mësuesi mentor i institucionit ku bëhet praktika. ²⁴. Në “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së” në nenin 95 “Diplomimi” përcaktohen qartë procedurat e mbrojtjes së diplomës nga ana e studentëve.²⁵
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrit për përgjegjëse për arsimin.	Nga analiza e kurrikulës së programit të studimit evidentohet se ai bazohet tërësisht në vendimet dhe udhëzimet e ardhura nga MAS për institucionet e Arsimit të Lartë dhe të rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF.²⁶ Në fund të çdo viti akademik njësia bazë miraton kuotat për studentët brenda vendit, program i dytë studimi, transferim studimesh, shtetas të huaj, me statusin e jetimit, persona me AK si dhe romë e egjiptianë, kategoritë e veçanta të studentëve me status jetim, me ndihmë ekonomike, me prindër invalidë, kuota që dërgohen për miratim në Senat nga Dekanati e më pas bëhet shpallja në faqen zyrtare të UNIKO-së. Kjo është pasqyruar në Statutin e Institucionit në nenet, 4; 51,;55; 66;72.²⁷
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë	Nga analiza e planit mësimor të programit dhe nga diskutimi me stafin e departamentit konstatohet se Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ofruar për herë të parë

²² “Tabela përmbledhëse në anekset” Tabela nr.9

²³ “Plani mësimor 2024-25 i programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor.Evidenca nr.2.6

²⁴ “Formular vlerësimi I praktikës profesionale” Evidenca nr. 2.35

²⁵ “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së”neni 95. Evidenca nr.2.1

²⁶ Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së” Evidenca nr.2.1.

²⁷ Statuti i UNIKO-së” Evidenca nr.1.1

studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	për studentët në vitin akademik 1995-96 vit pas viti ka pësuar ndryshime. Krahasuar me vitin e parë të fillimit me kurrikulën në ditët e sotme vihet re se veprimtaritë formuese të paqyruara në programet lëndore janë në përputhje me Rregulloren e programit të studimit dhe janë 70% të njëjta me programet e IAL-ve të tjera.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga verifikimi i bërë sipas evidencave të paraqitura dhe vizita e realizuar në institucion rezulton se programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor, është në përputhje me fushën studimit dhe klasifikimet e bëra sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave ndërkombëtare Evropiane. <i>Ndonëse ka realizuar të gjitha procedurat e kërkuara për kodifikimin dhe klasifikimin e programeve sipas VKM nr.310 datë 11.05.2022, dhe ka bërë kodifikimin e syllabuseve, nuk ka një kod për programin ndonëse është përcaktuar në evidencën 3.27 kodi 63 BA0112S)²⁸</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Konstatohet se ky program studimi ofrohet vetëm nga Departamenti i Edukimit në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë në UNIKO dhe nuk është program i përbashkët studimi.
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kritereve 1-8 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit përmbush kriteret ligjore për ndërtimin dhe zbatimin e kurrikulës së tij, ofron formim akademik dhe praktik të domosdoshëm, ndërsa plani mësimor dhe përmbajtja e tij, me anë të lëndëve bazë, të formimit profesional, atij me zgjedhje, apo detyrime përmbyllëse etj, respekton kriteret ligjore, si dhe ai është në përshtatje dhe me ngjashmëri me programe të këtij lloji që ofrojnë universitete të tjera në vend.</i> <i>Në RVB nuk është pasqyruar kodifikimi i programit të studimit sipas VKMnr. 310 datë 11.05.2022, ndonëse në evidencën nr.3.27 jepen procedurat e ndjekura për kodifikim të programeve që ofron UNIKO.</i> <i>GVJ rekomandon që të disa nga lëndët që janë të përbashkëta me arsimin fillor të jenë më të thelluara me mësimdhenien në</i>

²⁸ "Praktika të kodifikimit të programeve të studimit" Evidenca nr.3.27

	<i>kopshte dhe nivelin parashkollor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe nga vizita e realizuar në institucion, rezulton se njësia bazë – Departamenti i Edukimit (DE) – dhe njësia kryesore – Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) – funksionojnë në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë, si dhe me Statutin e institucionit. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, përbëhet nga 4 njësi bazë: 1. Departamenti i Edukimit; 2. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë; 3. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 4. Departamenti i Histori dhe Gjeografisë; Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, ku për vitin akademik 2024-2025 kanë kualifikimin si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>2</td><td>9</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>9</td><td>7</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>24</td><td>7</td></tr><tr><td>Msc</td><td>7</td><td>17</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>42</td><td>40</td></tr></table> Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Departamenti i Edukimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë		PAE	PAK	Prof.Dr	2	9	Prof.Asoc	9	7	Dr/PhD	24	7	Msc	7	17	Gjithsej	42	40
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	2	9																			
Prof.Asoc	9	7																			
Dr/PhD	24	7																			
Msc	7	17																			
Gjithsej	42	40																			

	paraqiten si më poshtë për vitet akademike:					
	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
Tituj/ grada	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	4	1	6	1	5
Prof. Asoc.	-	-	-	3	-	3
Dr./PhD.	5	-	5	-	5	-
Msc.	6	8	6	7	6	8
Totali	12	12	12	16	12	16
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Rezulton se Njësia bazë përgjegjëse për realizimn e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” përmbush detyrimet ligjore lidhur me kualifikimin e stafit akademik pasi nga 12 pedagog që ka departamenti në vitin akademik 2024-2025, 6 anëtarë të stafit janë më tituj dhe grada shkencore dhe 6 janë me MSC, por duhet të kërkojë më shumë lidhur me kualifikin e mëtejshëm të këtij stafi. Nga ana tjetër, nga takimet me stafin mbështetës dhe me studentët, rezulton se studentët mbështeten nga një personel ndihmës akademik gjatë procesit mësimor dhe veprimtarive që realizohen në këtë program studimi. Lidhur me realizimin e praktikave mësimore konstatojmë se departamenti angazhon 3 pedagogë tutor si dhe mësuesit mentor në kopshte, por edhe si e kemi theksuar edhe më parë nuk ka një program lënde për praktikën. ²⁹					
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga takimi me stafin që mbulon programin konstatohet se rolin e koordinatorit të këtij programi studimi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit, e cakton përgjegjësja e departamentit. Ajo përcakton pedagogët përgjegjës sipas kurseve, të cilët janë pedagogë që japin mësim pranë këtij programi në një vit akademik ³⁰ Megjithatë, GVJ rekomandon se departamenti duhet të punojë më shumë për efektivitetin e veprimtarisë së këtyre strukturave ndihmëse të programit pasi në takimin me studentë rezultoi se kordinatori nuk njihej nga studentët.					
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–3 të Standardit II.2, si dhe në gjetjet e evidentuara					

²⁹ “ Rregullore e programit të studimit AP 2023-2026” Evidenca nr.2.4

³⁰ “Vendimi i njësise për përcaktimin e kordinatorëve të programeve të studimit” Evidenca 3.2

	nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se: - Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin; - Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë të punësuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, etj; Departamenti ka përzgjedhur kordinatoren e programit të studimit i cili ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit, megjithatë <u>GVJ rekomandon</u> se departamenti duhet të punojë më shumë për efektivitetin e veprimtarisë së këtyre strukturave ndihmëse të programit pasi në takimin me studentë rezultoi se kordinatori nuk njihej nga studentët			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Konfirmojmë se Njësia kryesore-Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Njësia bazë-Departamenti i Edukimit disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat i gjejmë të reflektuara në Rregulloren e UNIKO-së, Rregulloren e FEF-së, Rregulloren e DE-së, Rregulloren e programit të studimit AP, Kurrikulën e programit të studimit, Planin mësimor të miratuar dhe në një sërë udhëzimesh që rregullojnë realizimin e procesit mësimor. ^{31/32/33}
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, përkatësisht të planit mësimor dhe të programeve lëndore (Syllabuseve) evidentohen informacionet e nevojshme për kreditet e lëndëve apo moduleve, ngarkesën javore e ngarkesën e përgjithshme mësimore në auditor, detyrimet në përfundim të lëndës/modulit

³¹ "Rregullore e programit të studimit AP 2023-2026" Evidenca nr.2.4

³² "Rregullore e brendëshme e Departamentit të Edukimit" Evidenca nr.2.2

³³ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së" Evidenca nr. 2.1

semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	(provim/firmë). Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor" ofron në mënyrë të detajuar lëndët dhe shtrirjen përgjatë vitit akademik, si dhe paraqitet për çdo lëndë kohështrirje vjetore apo semestrale, duke përcaktuar javët mësimore, orët e leksioneve, orët e seminareve, orët jashtë auditorit, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse për secilën lëndë/modul. ³⁴
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dosjes të programit, verifikimet e bëra vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët vihet re se studentët kanë mundësi që të njihen me përmbajtjen e programit dhe aspekte të tjera të funksionimit të tij në dokumentet e paraqitura online në faqen e internetit të IAL https://unkorce.edu.al/ (Studentët në rubriken Informacion i përgjithshëm dhe tek DE dhe FEF si fakultet). ³⁵ Në mbështetje të studentëve janë edhe rregulloret dhe udhërfyese për studentë, që vihet në dispozicion studentëve në ditën e parë të shkollës, ku studentët njihen me strukturën, kurrikulën, detyrimet. Po ashtu secili pedagog bën njohjen me detyrimet dhe kërkesat që lidhen me lëndën specifike në fillim të lëndës, sipas semestrave. ³⁶
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Gjatë analizimit të kurrikulës dhe programeve të lëndëve si dhe me takimin me stafin akademik konstatojmë se në planin mësimor paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha lëndët në përputhje me VKM nr 41 datë 14.01.2018," Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga IAL-të" dhe "Rregulloren e organizimit të veprimtarisë mësimore shkencore në FEF" ku është shtuar një element "Kodi i Etikës" ^{37/38} Në plan paraqiten lëndët, shtrirja përgjatë vitit akademik, orët e seminareve, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse. Programet lëndore paraqesin gjithashtu një përmbajtje të lëndës, rezultatet e të nxënës, konceptet kyç, temat, format e kontrollit dhe literaturën, të gjithë ³⁹
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është	Nga analiza e programeve të studimit 2022-25; 2023-26 dhe 2024-27 si dhe takimi me stafin që mbulon programin

³⁴ "Plani mësimor Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor! Evidenca nr.2.5

³⁵ "Faqe zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al/> (Studentët në rubriken Informacion i përgjithshëm) dhe DE

³⁶ "Faqe zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al/> (Studentët në rubriken Informacion i përgjithshëm) Guida e studentëve.

³⁷ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF" Evidenca nr. 2.1

³⁸ "Rregullore e programit të studimit AP" Evidenca nr. 2.4

³⁹ "Programet e programit të studimit AP" Evidenca nr. 2.12

në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	konstatohet se ky program studimi ka ndryshuar si në kredite ashtu edhe në lëndë kushtëzuar kjo nga diskutimet që bëhen në çdo fillim viti akademik mes Zv Rektorit për problemet mësimore, Drejtorisë së kurrikulave dhe Drejtorit të Departamentit, të dhënat që merren nga studentët, si dhe udhëzime të MAS apo VKM, duke u pasuruar ose përmirësuar qoftë në përmbajtjen, por dhe në aspektin metodologjik.⁴⁰ <i>Në RVB e paraqitur nuk jepen të dhëna konkrete për ndryshimet e bëra, por në analizen e pyetsorit të studentëve të organizuara nga NJSBC janë dhënë rekomandime për përmirësim në praktikën profesionale, përdorimin e teknologjisë etj.⁴¹</i>			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore, njësia bazë ka arkivë për dokumentacionin e programit, studentët informohen online dhe në auditor lidhur me përmbajtjen e tij, <i>Programi ka pësuar përmirësim si në programet lëndore ashtu edhe në kredite gjë që dëshmon një qasje dinamike dhe të orientuar drejt cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose	Nga shqyrtimi i dosjes së programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” rezulton se programi i ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për aftësimin e zhvillimin e kompetencave shkencore, psiko-pedagogjike e profesionale për një punësimin e tyre të ardhshëm. Programi i studimit bazohet në një kurrikul me ngjashmëri me programet bashkëkohore të së njëjtës fushë që ofrohen nga

⁴⁰ “Praktika të ndryshimeve në kurrikul” Evidenca nr.2.17; “Plani Mësimor 2022 – 2027” Evidenca nr.2.5

⁴¹ “Të dhëna nga pyetsori me studentë i NJSBC” Evidenca nr.2.23

punësimin e studentëve.	universitete të tjera në vend krijon mundësinë e vazhdimin të studimeve në një nivel më të lartë kualifikimi.⁴² Konstatohet se programi ofron jo vetëm orë në auditor, por edhe orë në laboratore e në terren përmes praktikës aktive e pasive në shkolla. Konkretisht programi përmban: - 1146-orë leksione; - 901-orë seminare; - 175-orë praktike në shkollë; - diploma/provim formimi 150 orë; - Totali 2047 orë në auditor gjatë tre viteve akademike dhe 2453 orë jashtë auditorit.⁴³
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga një analizë e strukturës dhe përmbajtjes së planit mësimor, ndarjes së veprimtarive formuese në kategori A, B, C, D, E shtrirja e tyre përgjatë vitit akademik, tipologjia e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse, formati i syllabuseve, me elementët përbërës, rezultojnë se janë në përputhje dhe ndihmojnë në realizimin e objektivave formuese të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit^{44/45}. <u>Megjithatë, siç u theksua edhe në takimin përmblyllës me stafin, disa nga syllabuset nuk janë sipas formatit të kërkuar nga udhezimi i MAS-së, (temat dhe literatura e dhënë për cdo temë) apo edhe duhet të rishikohen edhe njëherë përse i përket përmbajtjes sipas nivelit që jepen, Lëndë si “ Bota sociale e fëmijës”, “Letërsi për fëmijë”, “ Njohuri në kompjuter në moshë të vogël” që kanë të njëjtën tematikë me programin AF)</u>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga analiza e dosjes së programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, nga takimi me stafin dhe me studentët evidentohet se programi ka 180 kredite të ndara në 3 vite e sipas lëndëve e moduleve, në përputhje me profilin e programit të studimit.⁴⁶ Lëndët në programe kanë ngjashmëri edhe me programet e universiteteve në vend, kjo bazuar edhe në Ligjin e Arsimit të

⁴² “ Model diplome dhe suplementi të programit të studimit MAP” Evidenca nr.2.7

⁴³ “Tabele përmbledhëse Anekset” Evidenca nr.4

⁴⁴ “Rregullore e Programit të studimit bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor” (pika 3 objektivat dhe rezultatet e të nxënit) Evidenca nr.2.4

⁴⁵ “ Programet e lëndëve model syllabusi” Evidenca nr. 2.12

⁴⁶ “Plani mësimor I programit AP . Evidenca nr.2.5

	Lartë, dhe udhëzimeve të bëra nga grupi i punës për unifikimin e kurrikulave pranë MAS.⁴⁷ Në përmisimin e strukturës së programit ka ndihmuar edhe bashkëpunimi me fakultete homologe jashtë vendit bazuar në marrëveshjet e bëra me to si: Departamenti i Shkencave të Edukimit "Giovanni Maria Bertin" në Universitetin e Bolonjës, kualifikimet e realizuara në kuadrin e projekteve Erasmus+, si dhe raporti i ekspertëve AADF- READ 2024.⁴⁸ Raporti teori-praktikë është i arsyeshëm dhe i pranueshëm për formimin profesional të studentëve
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit rezulton se ai është ndërtuar në përputhje me kriteret ligjore, dhe veprimtaritë formuese janë ndarë në disiplina dhe përqindje kreditesh sipas VKM-së nr 41 datë 24.01 2018. Konkretisht, struktura e programit përfshin: - Disiplina të formimit të përgjithshëm (simboli A) – 34 ECTS; - Disiplina të formimit karakterizues (simboli B) – 97 ECTS; - Disiplina ndërdisiplinore/integruese (simboli C) – 22 ECTS; - Lëndë plotësuese (simboli D) – 21 ECTS; - Detyrime përmbyllëse (simboli E) – 6 ECTS;⁴⁹ Kjo strukturë e programit raporti mes teorisë dhe praktikës 2047 / 2453 (orë pune individuale dhe praktika mësimore), vlerësimi i studentëve nepërmjet projekteve, jo vetëm që realizon objektivat e programit por edhe lejon transferimin apo punësimin e tyre.^{50/51}
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe takimi me stafin e programit rezulton se bëhen përpjekje për përditësimin e përmbajtjes së programeve lëndore kushtëzuara këto si nga eksperiencia e fituar nga projektet ku pedagogët marrin pjesë, apo edhe nga kërkesat e tregut të punës, apo mendimeve të marra nga studentë të Alumnit, por këto ndryshime nuk përfshijnë tërësinë e lëndëve. Kujdes duhet të tregohet edhe për përditësimin e literaturës së detyruar dhe ndihmëse. Kjo literaturë duhet të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke iu referuar botimeve të 5 viteve të fundit. Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe gjendet në

⁴⁷ "Vendim I grupit të punës për unifikimin e kurrikulave nga MAS. Evidenca nr.2.18

⁴⁸ " Marrëveshja me Bolonjën" Evidenca nr. 3.13

⁴⁹ "Tabela përmbledhëse Anekset " Tabela nr.9

⁵⁰ "Praktika e plotë e procedurave të transferimit të studentëve „ Evidenca nr.2.15

⁵¹ " Rregullore e organizimit dhe Veprimtarisë mësimore shkencore të FEF" Evidenca nr.2.1

	bibliotekat online dhe bibliotekën e fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë ⁵² <u>Mendojmë se literatura e përdorur në syllabuse duhet të përditësohet për cdo vit akademik duke përfshirë edhe tekste apo informacion të fundit.</u>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Konfirmojmë se programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor me 36 lëndët që përmban, ofron njohuri aftësim dhe kompetenca për t’i bërë mësues të aftë profesionalisht dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës, bazuar në grup lëndët e karakterit formues shkencor dhe profesional, detyrave të kursit dhe projekteve, duke ju referuar Kompetencave të Arsimit Parashkollor sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor dhe synimeve të përcaktuara në program. ⁵³			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga një analizë e përmbajtjes së programit të studimit veprimtarive formuese të hartuara konform kërkesave që lidhen me standartet e cilësisë, rezulton se ky program mundëson vazhdimësinë e studimeve në nivel më të lartë studimi, por edhe mundësi punësimi në institucionet e arsimit parashkollor. ⁵⁴			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore dhe vëren se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kurrikulës së Arsimit Parashkollor, si dhe synon formim të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <u>GVJ rekomandon</u> se duhet punuar më shumë për përmisimin tërësor të lëndëve në tërë elementët e tyre sidomos në përditësimin e literaturës, si dhe ofrimin tek disa lëndë të tematikës më afër nivelit të parashkollorëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

⁵² “Pregramet lëndore, model syllabus” Evidenca nr. 2.12

⁵³ “ Rregullore e programit të studimit AP (2023-26)”Objektivat formuese Evidenca nr.2.4

⁵⁴ “ Model diplome dhe suplementi bachelor MAP” Evidenca nr.2.7

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në RVB e paraqitur nga grupi i punës lidhur me këtë kriter rezulton se si në dokumentacionin që disponon institucioni (Statuti, Rregullore studimi të fakultetit, departamentit dhe të programit të studimit) ashtu edhe në raportet e analizave të bëra nga NJSBC objektivi është përmisimi i vazhdueshëm i programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”⁵⁵ Konstatohet se janë bërë ndryshime si në lëndët dhe përmbajtjen e tyre, sidomos në kreditet, <i>por një evidencë ku të jenë dokumentuar sugjerimet e bëra nga stafi, studentë apo detyra të lënë nga NJSBC nuk disponohet.</i> Ka sugjerime nga NJSBC për përmisimin e infrastrukturës mbështetëse për realizimin e programit praktikën profesionale, përditësimin e literaturës, por jo për ndryshime në strukturën apo lëndë të planit mësimor.⁵⁶ <i>GVJ sugjeron se tek disa lëndë si “Përdorimi i kompjuterit për moshë të vogël” apo Letërsi për fëmijë” përmbajtja të jetë më afër objektivave formuese të lëndës për nivelin parashkollor.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimi me stafin, studentët dhe përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit, rezulton se studentët përfshihen dhe kanë përfaqësues në të gjitha njësitë vendimmarrëse dhe të sigurimit të cilësisë (Senat; Këshillin studentor; NJSBC) lidhur me përmisimin e programit të studimit . Me studentët dhe punëdhënësit Departamenti i Edukimit realizon takime dhe diskutime të hapura, për të marrë mendime për ndryshimet e nevojshme që duhen bërë në program.⁵⁷
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet	FEF dhe DE si njësi përgjegjëse të realizimit të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” rezulton se në funksion të përmisimit dhe përditësimin të këtij programi kanë bashkëpunuar jo vetëm me njësi brënda institucionit (DKVI; NJSBC; SKVIA) por edhe me partnerë të institucioneve

⁵⁵ “ Statuti I UNIKO-së” “ Rregullore studimi e UNIKO-së” “Rregullore e DE” Evidencat nr. 1.1;1.2;2.2

⁵⁶ “ Të dhëna nga pyetori me studentët nga NJSBC dhe SKVIA “ Evidenca nr.2.23.

⁵⁷ “Manuali I cilësisë së UNIKO” (Roli i aktorëve në UNIKO për sigurimin e cilësisë) Evidenca 1.16

dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	homologe në vend si UT, UE dhe shoqata të ndryshme si dhe universitete të huaja (Univeriteti i Selanikut). ^{58/59}			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kritereve I-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, megjithatë <u>GVJ sugjeron</u> se tek disa lëndë si “Përdorimi i kompjuterit për moshë të vogël” apo Letërsi për fëmijë” përmbajtja të jetë më afër objektivave formuese të lëndës për nivelin parashkollor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	GVJ nga takimet me stafin e programit dhe me studentët, evidenton se në programet lëndore, të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” aplikohen forma dhe rrugë të larmishme të proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënës dhe të vlerësimit të tilla si: mësim në auditor (

⁵⁸ “ Plani mësimor bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor 22.27” Evidenca nr.2.5

⁵⁹ “Marrëveshje në rang fakulteti “ Evidenca nr.3.14

seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	leksionet, seminare, laboratorët orët e hapura), studim individual, vlerësimi nepërmjet testimeve me gojë , me shkrim, detyrat e kursit/estetë, punë në grup, projekteve etj., praktikat profesionale, sipas formatit të miratuar nga Statuti dhe rregulloret e institucionit. ⁶⁰ Evidentohen se ka edhe një sistem monitorimi të realizimit cilësor të këtyre formave të mësimdhënies nepërmjet njësive përkatëse. ⁶¹
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga pyetsori me studentë nga NJSBS-së rezulton se në përgjithësi studentët janë të kënaqur me larminë e metodave të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët që përmbushin nevojat e tyre. Njësia bazë ka ngritur një sistem trainimi për stafin për përmisimin e vazhdueshëm të performancës së pedagogëve dhe implementimin e metodave bashkohore në mësim, në përputhje me objektivat e saj. ^{62/63}
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ në takimit me stafin e Departamentit ka evidentuar se FEF dhe njësia bazë DE mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave profesionale të mësimdhënies. Konstatohet se stafi akademik është nxitur dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme duke u bërë pjesë e programeve të ndryshme për mobilitet të stafit akademik në universitete homologe nepërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit dhe projekteve Erasmus+ ku lektorët kanë pasur mundësi të krijojnë përvojën e tyre në mësimdhënie në auditorët e këtyre universiteteve. ^{64/65}
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik	Nga takimet me pedagogët, dhe studentët, analizë të raportit të pyetsorit me studentë organizuar nga Njësia të Sigurimit të Cilësisë verifikimeve në Zyrën e burimeve njerëzore, konstatohet se personeli akademik zgjidhet dhe zhvillon lëndë në përputhje me kualifikimin dhe kërkimin shkencor të tyre. ⁶⁶ Vihet re se është përmirësuar procesi mësimor në të gjithë elementët përbërës të tij dhe inkurajohen studentët për t'u angazhuar në gjatë leksionit, në zhvillimin e detyrave të kursit, angazhimit në projekte individuale apo të realizuara në grup. Studentët tregojnë se kanë marrëdhënie të mira me pedagogët dhe marrin prej tyre çdo informacion të nevojshëm duke

⁶⁰ "Rregullore dhe statuti i UNIKO" Evidenca nr.1.1 ; 1.2

⁶¹ "Raport I analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE 2023-24" Evidenca nr.2.10

⁶² "Raport I analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE 2023-24" Evidenca nr.2.10

⁶³ "Qendra e Formimit të vazhdueshëm " Faqja zyrtare e UNIKO-së. <https://unkorce.edu.al/> (rubrika rreth nesh)

⁶⁴ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale" Evidenca nr.3.10

⁶⁵ "Certifikate pjesmarjeje e stafit akademik në marrëveshje ndërkombëtare" Evidenca nr. 3.15

⁶⁶ "Procedura te rekrutimit të Stafit Akademik." Evidenca 3.5 dhe 3.6

si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	komunikuar me ta, nepërmjet postës elektronike të lektorëve, orari i pritjes në zyrë nga secili lektor.⁶⁷
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga takimet me stafin dhe me studentët konstatohet se FEF dhe DE që janë përgjegjës për programin e studimit, kanë vlerësuar procesin e përmirimit të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies nga ana e pedagogëve duke realizuar trainime nga sektorë të caktuar të institucionit si AKKSHI dhe Zyra e Erasmus+. ⁶⁸, por nuk kishte ndonjë program konkret aktual për trainimin e stafit. Nga ana tjetër institucioni ka vlerësuar shumë procedurat e vlerësimit të programit si feedback-un e studentëve që merret me anë të pyetësorëve, sodazheve, mendimeve të stafit dhe analizës së NJSBC-së, duke i marrë në konsideratë për të përmirësuar dhe për të sjellë risi në mësimdhënie me anë të përdorimit të metodologjive dhe teknologjive të mësimdhënies. Departamenti realizon vlerësimin e pedagogëve dhe kjo konsiderohet një rrugë e efektshme për përmirësim të vijueshëm⁶⁹.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni si dhe nga takimi me zv/dekanin dhe me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional konstatohet se UNIKO-ja bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 37, pika 1 dhe neni 38, si dhe nenin 7;20;23, të Rregullores së brendshme të UNIKO-s, realizohet procesi i bashkëveprimit dhe kontrollit të njësisë përgjegjëse të programit si dhe dhe monitorimit në të procesit të mësimdhënies.^{70/71}

⁶⁷ "Model analize në fund të një moduli" Evidenca nr. 2.28

⁶⁸ "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së projekteve dhe Kërkimit Shkencor". Evidenca nr.1.23.

⁶⁹ "Raport institucional i vlerësimit të brendshëm të NJSBC të UNIKO" Evidenca nr. 2.19.

⁷⁰ "Rregullore e UNIKO-s. Evidenca nr.1.2

⁷¹ "Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional" Evidenca nr.1.5



vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve të planifikuara;</i> <i>Këto metoda mbështesin në mënyrë të qëndrueshme arritjen e rezultateve të planifikuara të të nxënës, në përputhje me objektivat formues të programit;</i> <i>Departamenti i Edukimit përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Zhvillimi i teknologjisë i ka sjellë më afër marrëdhënien pedagog student.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, nga diskutimi me pedagogë dhe me studentë evidentojmë se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, si dhe sjelljet etike përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit të UNIKO-së (nenet 63; 64;66;71;73), si dhe në programet e lëndëve (Syllabuset) ^{72/73} dhe u komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve të secilës lëndë/modul në fillim të lëndës . Studentët marrin informacion për format e vlerësimit të tyre nepërmjet faqes zyrtare të UNIKO-së rrjeteve sociale, grupeve mësimore dhe sistemit PITAGORA.⁷⁴

⁷² " Rregullore e UNIKO" Evidenca nr. 1.2

⁷³ " Programet e lëndëve syllabuset" Evidenca nr. 2.12

⁷⁴ " Faqja zyrtare e UNIKO" <https://unkorce.edu.al/> (Rubrika Studentët.Informacion i përgjithshëm)

Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga verifikimi i dokumentacionit në IAL dhe nga diskutimi me studentë rezulton se ditën e parë të zhvillimit të mësimit për çdo lëndë titullarët e tyre u prezantojnë studentëve metodologjinë e testimit (vlerësimin e vazhduar, vlerësimin në provim) që lidhen me vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Ky informacion u mundësohet studentëve dhe nepërmjet Udhërëfuesit të studentëve (në Faqen zyrtare Rubrika Studentët), por dhe gjatë gjithë vitit akademik me sistemin ESSE3 ose Pitagora.⁷⁵
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga shqyrtimi i Rregullores së UNIKO dhe Programit të studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”⁷⁶, si dhe nga bisedat me stafin dhe me studentët konstatohet se mënyra e vlerësimit të studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar (testimet e ndërmjetëse; aktivizimi në seminare, projekte ose detyrat kursi) dhe provimin final i lëndës. Rezulton se në UNIKO është përcaktuar në Rrregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore të FEF-së neni 91 sistemi i vlerësimit me pikë që konvertohen në notë i njohurive, (1-39 pikë nota 4 ; 40-50 nota 5; 51-60 nota 6; 61-70 nota 7; 71-80 nota 8; 81-90 nota 9; dhe 91-100 nota 10)⁷⁷
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DE si njësi bazë që mbulon programin e studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor, përdor një sërë formash dhe aktiviteteve për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies si diskutime të hapura në njësinë bazë; përfshirjen e studentëve me forma të ndryshme në mësimdhënie;por edhe vlerësimin e procesit mësimor nepërmjet pyetësorëve të studentëve,analizës së vërtetimit nga strukturat e caktuara në Rektorat.^{78/79} Të dhënat e marra nga tërë strukturat analizohet dhe rivlerësohet në shërbim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe performancës së pedagogëve.⁸⁰
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në	Nga vlerësimi i punës së strukturave përgjegjëse për mësimdhënien si dhe nga takimi me stafin pedagogjik dhe studentë, rezulton se institucioni i kushton rëndësi përdorimit të metodave sa më fleksibël dhe të larmishme në procesin mësimor, për të siguruar arritjen e pritshmërive dhe objektivave formuese

⁷⁵ “ Manual I Sistematik Elektronik Pitagora” Evidenca nr.1.6.1

⁷⁶ “ Rregullore e programit të studimit AP (2023-24) . Evidenca nr.2.4

⁷⁷ “ Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore në FEF” Evidenca nr.2.1

⁷⁸ “Raport I analizës së punës mësimore shkencore të DE (2023-24).Evidenca nr.2.10

⁷⁹ “ Të dhëna nga pyetësi me studentë NJBSC SKVIA” Evidenca nr. 2.23

⁸⁰ “ Të dhëna nga Pyetësi I NJBSC” Evidenca nr. 2.22

përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	sipas kërkesave të tregut. Nga takimi me studentë konfirmohet se pedagogët përdorin larmi metodash dhe kanë krijuar një frymë komunikimi dhe bashkëpunimi me to. ⁸¹			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kritereve I-5 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se:</i> <i>IAL zbaton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre;</i> <i>Departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies, në këtë proces një rol të rëndësishëm ka mendimi i studentëve, i cili tërhiqet me anë të anketave, ku pyeten edhe për format dhe metodat e mësimdhënies;.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të	Nga shqyrtimi i Rregullores së UNIKO (neni 76; 77; 78; 84) e pasqyruar kjo edhe në Rregulloren e Njesisë kryesore dhe bazë, si dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatohet se testimi dhe vlerësimi i njohurive, i dijeve dhe aftësive profesionale për studentët realizohet gjatë gjithë vitit akademik duke u bazuar në vlerësimin e vazhduar 30% (testimet

⁸¹ "Rregullore e UNIKO" Evidenca nr. 1.2

parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	e ndërmjetëse; aktivizimi në seminare, projekte ose detyrat kursi) dhe provimin final i lëndës 70%, në total 100 pikë. Me pikët e vlerësimit gjatë vitit studentët njoftohen nga pedagogu i lëndës dhe pasqyrohet në sistemin Pitagora.⁸² Format e vlerësimit të studentëve së bashku me elementë të tjerë të lëndës janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditur studentëve në fillim të lëndës, nga pedagogu titullar.⁸³
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Konstatojmë nga takimi me stafin akademik dhe studentë dhe Drejtorinë e Kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, se UNIKO po zbaton sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit Clean Score të financuar nga AADF për testimet me shkrim dhe tekste ndërkombëtar të përkthyer në shqip.⁸⁴ Nga takimi me studentë kjo formë vlerësimi shikohej si shumë e vlefshme dhe e shpejtë, pasi marrin feedback të menjëhershëm.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së UNIKO dhe Syllabuseve) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatojmë se Vlerësimi përfundimtar i lëndës është rezultat i dy përbërësve që lidhen me vlerësimin e vazhduar me përbërësit përkatës, sipas programit lëndor (syllabusit), si dhe vlerësimit në provim. Rezulton se Sipas rregullores provimi në auditorin ku zhvillohet provimi të jenë së paku 2 pedagogë gjatë sezonit të provimit, ku njëri prej tyre është kryetari i komisionit (titullari i lëndës/modulit), ndërsa anëtar i tjetër asiston si pjesëtar i të njëjtit grup mësimor, ku bën pjesë lënda.⁸⁵ Tezat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili kontrollon nivelin e përmbajtjes së tezës, shkallën e vështirësisë së saj, kohëzgjatjen e provimit mbështetur në pyetjet e përfshira në provim, shpërndarjen e pikëve për secilën pyetje, etj.⁸⁶
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të	Konstatojmë se Vlerësimi i njohurive të studentëve si ai gjatë vitit ashtu edhe ai final, si edhe del nga takimi me studentë, shoqërohet me komente që lidhen dhe me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 8 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni bën ballafaqimin me studentët dhe 48 orë zgjat procedura për ankimin e studentëve lidhur me korrigjimin e provimeve.⁸⁷

⁸² "Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë" Evidenca nr.1.2

⁸³ "Programet e lëndëve model Syllabusi" Evidenca 2.12

⁸⁴ "Model testimi në CleanScore" Evidenca nr. 2.21

⁸⁵ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore në FEF" Evidenca nr. 2.1

⁸⁶ "Model teze provimi MAP" Evidenca 2.25

⁸⁷ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore në FEF" Evidenca nr. 2.1

përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga analiza e Rregullores së programit të studimit bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor, por dhe nga diskutimet me pedagogët dhe studentët kontatojmë se në provime dhe në paraqitje të temave dhe detyrave zbatohen rregulla dhe procese që lidhen me monitorimin dhe me zbatimin etik, antiplagjiaturë të krijimeve të studentëve. Studenti konsiderohet mbetës në provim kur shkel elementet e Kodit të Etikës (neni 16;17;18) ⁸⁸ , sipas përcaktimeve në kod (detyrimi i studentëve për të mos kopjuar në provime, ose punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik e atij mbështetës, mos përdorim në provim celularin) etj.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga analiza e dokumentacionit që lidhet me vlerësimin e studentëve por dhe nga bisedat me pedagogë dhe me studentë konstatojmë se studentët informohen në kohë për arritjet e tyre (ata presin deri në 8 ditë për marrjen e notës). Ekzistojnë procedura të zbatueshme për ankimim, kurse rezultatet e kontrollit të dijeve për vlerësimin e vazhduar të studentit jepen orën e fundit të seminarit. ⁸⁹
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Siç është përmenduar dhe më lart pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar dekanit të fakultetit Kërkesa pastaj i dërgohet departamentit, i cili krijon një komision ad-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës ⁹⁰ .
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga bisedat me studentët konstatojmë se personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve të tyre, në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prani të personelit akademik të kursit, për t'u ballafaquar me rezultatet e tyre dhe për të marrë sqarimet e duhura. Personeli akademik pasqyron në sistem rezultatet brenda afateve të caktuara dhe duhet t'i dorëzojë procesverbalet e firmosura dhe provimet të mbyllura në një zarf, në sekretarinë mësimore. Pas daljes së rezultateve studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin brenda 48 orëve dhe ankimimi dhe

⁸⁸ "Kodi i Etikës UNIKO. Evidenca 1.19

⁸⁹ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore në FEF" Evidenca nr. 2.1

⁹⁰ Evidencë-3.1-Rregullore e FE 2019.

	vendimi i marrë rregjistrohet dhe ruhet në Dekanat.			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se:</i> <i>Institucioni garanton një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe të mbështetur në meritokraci, duke respektuar të gjitha procedurat e parashikuara për të siguruar integritetin akademik;</i> <i>Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin e miratuar të vitit akademik.</i> <i>Gjithashtu, IAL ka të strukturuar dhe funksional mekanizmin e ankimit, i cili i mundëson studentit të kërkojë rivlerësim në rast të pakënaqësisë me rezultatet, duke forcuar më tej besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë e sistemit të vlerësimit;</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga një analizë në planin mësimor, e lëndëve të ndara sipas veprimtarive formuese, si lëndë bazë (përgatitje metodologjike dhe shkencore), lëndë karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore), lëndë integruese ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, dhe përbajtjes së tyre konfirmojmë se përgjithësisht ato synojnë të japin njohuri të thelluara teorike dhe aftësimin e tyre profesional për të punuar në Arsimin Parashkollor dhe më gjërë. ⁹¹ Rezulton se plani mësimor pajis studentët edhe me aftësi specifike në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, formim të elementëve bazë të etikës profesionale për komunikim, aftësimin për të punuar në grup me realizim projektsh etj. ^{92/93}

⁹¹ "Plani mësimor sipas veprimtarive formuese." Tabela 9. Evidenca Tabela përmbledhëse për anakset.

⁹² "Programet lëndore të prgramit" Evidenca 2.5

⁹³ "Rregullore programit të studimit AP e" Evidenca 2.4

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Si edhe e theksuam më sipër lëndë të caktuara në planin mësimor bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” si: “Edukim teknologjik dhe metodologji”; “Partneritet me komunitetin”; “Komunikim pedagogjik”; “Etika profesionale e mësuesit”; “Administrim i institucioneve shkollore” etj, jo vetëm realizojnë një formim teorik por edhe përmbushin objektivat e programit në realizimin e aftësive të veçanta të studentëve.⁹⁴
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga takimi me stafin dhe studentë konfirmojmë se DE në fund të cdo lënde analizon rezultatet e arritura bazuar edhe në objektivat e përcaktuara tek syllabusi, nepërmjet pyetsorëve dhe intervistave jo formale me studentë.⁹⁵ Në takimin me studentë ato deklarojnë se në fund të lëndës japin mendime lidhur me aspekte të ndryshme të lëndës si përmbajtjen, aftësimin e tyre bazuar në pritshmëritë, dhe sugjerojnë edhe ndryshimet që duhen bërë.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur	Nga analiza e programeve lëndore si dhe bisedat me stafin e programit konstatojmë se programet lëndore paraqesin kompetencat që synohen të formohen nga studentët në laboratorë dhe praktika profesionale dhe kërkesat e tregut të punës .Stafi gjykon se studentit i krijohet mundësia t’i zbatojë këto kompetenca gjatë orëve të leksioneve, duke u përfshirë aktivisht në to, gjatë diskutimeve në orët e seminareve, si dhe praktikës profesionale, e cila është një lëndë e veçantë që zhvillohet gjatë këtij programi. Mësimdhënia në këtë program studimi, kombinon formimin teorik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen praktikat profesionale, të cilat zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentëve.⁹⁶ <i>Sugjerojmë se për të përmbushur më mirë formimin praktik dhe profesional të studentëve duhet të krijohen ambiente të posacme për lëndët art figurativ dhe muzikor, arti skenik, edukim teknologjik.</i>

⁹⁴“ Rregullore programit të studimit AP e” Evidenca 2.4

⁹⁵ “ Model analize në fund të një moduli”


⁹⁶ “Rregullore e programit të studimit AP” Evidenca nr. 2.4

mobilitetin e studentëve.				
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga diskutimi me pedagogët me kohë të plotë dhe me kohtë të pjesshme rezulton se ata organizojnë trajnime brenda departamentit me stafin akademik të tij, mbi forma të reja të në mësimdhënies, ku stafi është njohur me metodat më të reja dhe teknologjinë që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.⁹⁷ FEF dhe Departamenti i Edukimit ka organizuar vazhdimisht trajnime mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, si dhe organizimin herë pas here të orëve të hapura për përmisimin e procesit të mësimdhënies tek stafi i përfshirë në këtë program etj. ⁹⁸			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit III.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se:</i> <i>Institucioni ka në funksion struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe të nxënie në kuadër të programeve të studimit;</i> <i>Syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira që duhet të arrijnë në përfundim të lëndës së zhvilluar;</i> <i>Këto struktura nxisin ndërgjegjësimin e stafit akademik dhe studentëve mbi rëndësinë e standardeve të mësimdhënies dhe zhvillimit profesional, duke kontribuar në garantimin e një procesi arsimor cilësor dhe të qëndrueshëm;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

⁹⁷ "Raport i analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE" Evidenca nr.2.10

⁹⁸ "Shembull I orëve të hapura në FEF" Evidenca nr. 2.26



Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, por dhe nga takimi me stafin e programit rezulton se Departamenti i Edukimit zbaton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.⁹⁹ Rezulton se në përfundim të programit studentët i nënshtrohen provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës dhe është departamenti që përcakton pragu e notës mesatare, e cila i jep të drejtën studentëve që nënshtrohen provimit apo punimit të diplomes. Departamenti i Edukimit respekton rregullat konform Manualit të posaçëm për punimin e diplomës bachelor.¹⁰⁰
Kriteri 2. Struktura përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimi me studentët ata rezulton se ato ndihmohen, dhe mbështeten lidhur me informacionet e domosdoshme për ta që kanë të bëjnë me vlerësimin përfundimtar, konstatojmë se ai është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit.¹⁰¹ Bazuar edhe në nenin 89, 90 të Rregullores së UNIK-së dhe në Manualin e hartimit të temës së diplomës, udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.^{102 /103}
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga takimi me stafin, me Përgjegjësin e departamentit dhe Dekanin rezulton se Provimi i formimit / punim diplome realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik i departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët hartojnë tezën e provimit final duke u mbështetur në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë marrë gjatë viteve të shkollimit¹⁰⁴.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i	Bazuar në Rregulloren e programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, si dhe në “Manualin e hartimit të

⁹⁹ “Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore të FEF”.Evidenca nr.2.1

¹⁰⁰ “Manual i hartimit të temës së Diplomes”.Evidenca 2.33

¹⁰¹ “Model teze provimi formimi”.Evidenca 2.25

¹⁰² “Fondi i pyetjeve të provimit të formimit të diplomës”.Evidenca nr. 3.28

¹⁰³ “Manual i hartimit të temës së Diplomes”.Evidenca 2.33

¹⁰⁴ “Model teze provimi formimi”.Evidenca 2.25

diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Diplomës” por dhe në bisedat me stafin e akademik të tij konstatohet se Pedagogu udhëheqës i diplomës orienton dhe mbështet studentin për punimin e diplomës, duke përcaktuar të gjitha procedurat e realizimit të punës, si takime dhe konsultime. Vlerësimi i punimit të diplomës bëhet konform formularit të vlerësimit sipas zërave të caktuar dhe të përcaktuar me pikë në total 100 pikë.¹⁰⁵
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga takimi me studentët konstatohet se IAL-ja ka mundur ato lidhur me realizimin e matjeve, testeve apo edhe analizave, për të cilat studentët kanë në dispozicion mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për të punuar në përgatitjen e temës së diplomës, si p.sh. laborator i teknologjisë, biblioteka etj. Studentët shprehin se ata ndihmohen nga stafi akademik i departamentit të pedagogjisë për realizimin e detyrimeve akademike të studentëve, apo për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizave statistikore, etj, që mund t'i duhet një student i përparë për të përgatitur temën e diplomës.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe nga takimet me stafin akademik evidentohet se zbatohen procedura zyrtare për përfundimin e provës finale. Për vlerësimin e provimit të formimit në bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” studentët vlerësohen me notë, nisur nga përgjigjet e dhëna në provimin me shkrim që ata bëjnë, duke u vlerësuar nga komisioni i ngritur prej 5 anëtarësh. Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur nga Departamenti i Edukimit dhe vlerësohet me pikë sipas formularit të vlerësimit (me 25 pikë secili aspekt) në total 100 pikë që më pas konvertohet në notë sipas rregullores.¹⁰⁶
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria	Nga takimet me studentë, me Sekretarinë, me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë rezultojnë se pas përfundimit të studimeve, studenti plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës (anglisht dhe shqip), të miratuara nga MAS. Ajo nënshkruhet nga

¹⁰⁵ “Formulari i vlerësimit të temës së diplomës” Evidenca nr.2.36

¹⁰⁶ “Formulari i vlerësimit të temës së diplomës” Evidenca nr.2.36

përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	dekani/drejtuesi i njësish kryesore të Fakultetit të Edukimit dhe nga Rektori i UNIKO. ¹⁰⁷			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga takimi me sekretarinë mësimore, nga bisedat me Përgjegjësen e Departamentit, si dhe me studentë konstatojmë se institucioni ruan gjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet / konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, ku respektohen të drejtat e privatësisë. Studentët shprehen se ata, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të dhënat janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretarive mësimore përkatëse, që përbën regjistrin themeltar, dhe në sistemin e menaxhimit të studentëve "Pitagora", i cili ruan informacionin dhe në formë elektronike. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore. ¹⁰⁸			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se: IAL-ja zbaton procedura zyrtare sa i takon detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës; Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të të gjithë studentëve të rregjistruar në të gjithë ciklet e studimit për një kohë të caktuar;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁰⁷ "Model diplome dhe suplementi" Evidenca nr.2.7

¹⁰⁸ "Statuti I UNIKO" Evidenca nr.1.1

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Stafi akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, që mbulohet nga Departamenti i Edukimit, është pjesë e këtij departamenti dhe i tre departamenteve të tjera të fakultetit, si dhe bashkëpunon me Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane.¹⁰⁹ Ky staf përmbush kërkesat ligjore dhe është i kualifikuar për të realizuar mësimdhënien në këtë program. Numri total i pedagogëve që japin mësim në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” gjatë tre viteve akademike, referuar dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion sipas kualifikimit të tyre, është si më poshtë:¹¹⁰ <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>-</td></tr><tr><td>Doc</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>8</td><td>2</td><td>8</td><td>3</td><td>8</td><td>1</td></tr><tr><td>Totali</td><td>18</td><td>4</td><td>18</td><td>5</td><td>18</td><td>4</td></tr></table> Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik: - Për 2022-2023, 54.5% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 45.5 % janë Msc; - Për 2023-2024, 56.5% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 43.5 % janë Msc; - Për 2024-2025, 59 % e pedagogëve kanë gradë	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	2	2	2	2	2	2	Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	1	Dr./PhD.	7	-	7	-	7	-	Doc	1	-	1	-	1	-	Msc.	8	2	8	3	8	1	Totali	18	4	18	5	18	4
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof.Dr.	2	2	2	2	2	2																																																		
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	1																																																		
Dr./PhD.	7	-	7	-	7	-																																																		
Doc	1	-	1	-	1	-																																																		
Msc.	8	2	8	3	8	1																																																		
Totali	18	4	18	5	18	4																																																		

¹⁰⁹ “Rregullore e programit të studimit AP (2023-2026).Evidenca 2.4

¹¹⁰ “Tabela përmbledhë se për anaket Tabela 6 ” Evidenca nr.4

	shkencore/tituj akademik, dhe 41% MSc; Nga shqyrtimi i syllabuseve që mbulojnë fushat e studimit, rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve që përfshihen në këtë program studimi disponojnë nivelin e duhur të kualifikimit dhe fushat kërkimore të tyre janë të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat e programit.¹¹¹ <i>Megjithatë, mendojmë se është e nevojshme të punohet më shumë për nxitjen e pedagogëve me MSC për të ndjekur një kualifikim të mëtejshëm, pasi raporti mes pedagogëve me gradë dhe tituj shkencorë dhe atyre me MSC është 54-59% %, gjë që tregon nevojën për rritjen e numrit të pedagogëve me kualifikime më të avancuara shkencore.</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i të dhënave mbi personelin akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, rezulton se stafi akademik efektiv, si dhe ai nga departamentet e tjera, është përgjithësisht në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018, “Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe me Rregulloren e UNIKO-s (nenet 28 dhe 102). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion sipas tabelave 12.1-12.3, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK për tre vite akademike është si më poshtë:¹¹² <table><tr><th>Viti Akdemik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>100 %</td><td></td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>89 %</td><td>11 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>100 %</td><td>-</td></tr></table> *shënim: ka mospërputhje midis të dhënave të stafit akademik për vitet 2022-2023 dhe 2024-2025, ku sipas tabelave 6.1,dhe 6.3 rezultojnë 4 staf akademik me kontratë, ndërkohë në tab 12.1 dhe 12.3 për këto vite akademike ngarkesa mbulohet 100% nga staf akademik efektiv, mungojnë të dhënat për stafin akademik me kontratë. Gjithashtu, bie në sy se disa pedagogë kanë një ngarkesë	Viti Akdemik	PAE	PAK	2022-2023	100 %		2023-2024	89 %	11 %	2024-2025	100 %	-
Viti Akdemik	PAE	PAK											
2022-2023	100 %												
2023-2024	89 %	11 %											
2024-2025	100 %	-											

¹¹¹ “Të dhëna për kualifikimin për stafin akademik në programin Bachelor Mësuesi për Arsimin Parashkollor ”

Evidenca nr.3.6

¹¹² “Rregullore e UNIKO-së Evidenca Nr. 1.2

	mësimore mbi normën e lejuar dhe mbulojnë një numër të konsiderueshëm lëndësh, që nuk janë plotësisht në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS).
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analiza e planit mësimor aktiv 2024-2025 dhe nga tabelat e paraqitura lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi ka qenë përgjithësisht i pandryshueshëm gjatë pesë viteve të fundit të funksionimit të tij, përveç rasteve kur një pedagog ka dalë në pension. ¹¹³ Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, për të gjithë stafin akademik, si për personelin me kohë të plotë (PAE) ashtu dhe për personelin me kohë të pjesshme (PAK), janë nënshkruar kontrata dhe janë paguar sigurimet shoqërore përkatëse. Përgjegjësi i Drejtorisë së Financave përditëson librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në bazë të përlogaritjes së kontributeve që çdo punonjës ka derdhur, duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e stafit akademik efektiv. ¹¹⁴
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i Rregullores dhe Statutit të Institucionit UNIKO, si dhe dokumentacionit të disponuar nga Departamenti i Edukimit dhe Burimet Njerëzore, rezulton se janë të përcaktuara procedurat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit akademik, si për atë me kohë të plotë, ashtu edhe për atë me kohë të pjesshme. Bazuar në Rregulloren e Institucionit (nenet 28, 29, 36, 37, 38, 39) dhe Rregulloren e Departamentit të Edukimit (nenet 15, 16, 17), Departamenti ka mundësinë të vendosë kritere specifike në përputhje me kërkesat që ka për pedagogët që do të rekrutojë, të cilat miratohen më pas nga Rrektori. ¹¹⁵ Në takimin me njësinë e Burimeve Njerëzore, u konstatuan procedurat e ndjekura në rekrutimin e stafit të ri, të cilat përputhen me rregulloret e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore (neni 7). Këto përfshijnë përcaktimin e kritereve të përgjithshme dhe specifike, shpalljen në aplikimin publik (APP), ngritjen e komisionit të vlerësimit, shqyrtimin e dosjes dhe intervistimin, të gjitha të realizuara në mënyrë transparente dhe të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. ¹¹⁶
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të	Nga dokumentacioni i paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe RVB-ja, konstaton se, për të siguruar një mësimdhënie të cilësisë së lartë, programi i studimit disponon laboratore të tilla si laborator i multimedias.

¹¹³ "Tabela për mbledhje se për anketat Tabela 6" Evidenca nr.6

¹¹⁴ "Rregullore e Drejtorisë së Financave" Evidenca nr.1.8

¹¹⁵ "Rregullore e UNIKO" Evidenca Nr. 1.2)

¹¹⁶ "Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore (neni 7)" Evidenca nr.1.4

mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<i>Megjithatë, nuk rezulton se ekzistojnë laboratore apo mjedise mësimore të tjera që janë në përputhje me natyrën specifike të programit. Aktualisht, Departamenti i Edukimit (DE) ka një punonjës të angazhuar si personel ndihmës akademik (sekretare e departamentit), ndërsa pjesa tjetër e stafit përbëhet nga personel akademik, të cilët përmbushin kërkesat dhe specifikimet e këtij programi studimi.¹¹⁷</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Të gjitha strukturat përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” të UNIKO-së, përfshirë Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Departamentin e Edukimit, Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, si dhe Sekretarinë Mësimore, bazuar në Rregulloren e programit të studimit, disponojnë një listë të plotë të personelit akademik që jep mësim në këtë program për çdo vit akademik dhe kanë informacion të plotë për realizimin e programit dhe periudhën kohore të përmbushjes së detyrave përkatëse. Dosjet personale të çdo anëtarit të stafit akademik efektiv dhe ndihmës akademik, të cilat përmbajnë informacion lidhur me karrierën e tyre dhe titujt akademikë, ruhen nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokollit i arkivit. Kjo zyrë disponon evidencat përkatëse të dokumentacioneve, të cilat ruhen dhe arkivohen në mënyrë të sigurt.¹¹⁸
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale,	Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se UNIKO dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) të Korçës dhe Bashkitë Pogradec, Devoll dhe Kolonjë për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit, si dhe me institucione të tjera të arsimit fillor.¹¹⁹ Njësia kryesore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, ka hartuar një manual të praktikës profesionale, i cili përmban qëllimet, objektivat dhe metodologjinë e vlerësimit të studentëve.¹²⁰ Në Rregulloren e Studimit të UNIKO-s (nenet 89 dhe 90) dhe të Departamentit të Edukimit (neni 22), janë përcaktuar qartë detyrat e strukturave

¹¹⁷ “Mjediset e Fakultetit Tabela 16”. Evidenca nr.4 Tabela përmbledhëse për Anekset.

¹¹⁸ “Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore”.Evidenca nr.1.4

¹¹⁹ Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për praktikave profesionale të programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.Evidenca Nr.4 (Tabela përmbledhëse Anekset)

¹²⁰ “Formular i vlerësimit të praktikës profesionale të studentëve”.Evidenca Nr.2.35

punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	dhe të personelit akademik lidhur me detyrimet përmbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi. ¹²¹			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbylljen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës, konfirmohet se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka të sanksionuara marrëveshje me institucionet pritëse për realizimin e praktikës mësimore dhe ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit mbikëqyrës në lidhje me studentët gjatë periudhës së praktikës. Po ashtu, janë specifikuar procedurat për plotësimin e raportit përfundimtar dhe formularit të vlerësimit, të cilat i dërgohen institucioneve përkatëse. ¹²²			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, dhe në veçanti Departamenti i Edukimit që mbulon këtë program studimi, disponon personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbyll standardet ligjore dhe akademike, duke u përputhur me fushën e programit.</i> <i><u>GVJ sugjeron</u> se duhet punuar më shumë për nxitjen e stafit në drejtim të kualifikimit të mëtijshëm, si dhe për rregullimin e ngarkesave të tyre në përputhje me udhëzimet e MAS.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin	Nga vizita në ambientet e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, rezulton se programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” disponon një infrastrukturë të mjaftueshme, e cila përfshin ambiente për leksione dhe seminare

¹²¹ “Regullore e UNIKO-së”.Evidenca Nr. 1.2

¹²² “Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të praktikës profesionale” Evidenca 3.12

e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	brenda ambienteve të fakultetit. Këto ambiente mundësojnë një mësim normal të këtij programi studimi, duke pasur parasysh numrin e ulur të studentëve. Fakulteti disponon 7 auditore për leksione me një sipërfaqe totale prej 660 m², 14 salla seminari me një sipërfaqe totale prej 705 m², dhe 2 laboratorë informatike. Gjithashtu, është në dispozicion një sallë promovimi me sipërfaqe 30 m², 2 salla biblioteke dhe ambiente ndihmëse.¹²³ Stafi akademik dhe administrativ janë të sistemuar në 13 zyra, të cilat janë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të punës. Për lëndët specifike si biologjia dhe fizika, përdoren laboratorët e fakulteteve përkatëse.¹²⁴
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Konfirmohet nga vizita në institucion se programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" mbështetet nga pajisje të teknologjisë bashkëkohore, të cilat sigurojnë realizimin efikas të procesit mësimor, si në aspektin teorik ashtu dhe praktik, përmes përdorimit të tyre në mësimdhënie. Godina e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF) është e pajisur me linjë interneti dhe intraneti (kabëll optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët. Përveç rrjetit të internetit kabllor (LAN), funksionon gjithashtu një sistem ëireless, duke mundësuar akses interneti për studentët edhe në ambientet jashtë klasave dhe auditorëve.¹²⁵
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në UNIKO disponon mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura me aparatura dhe mjete didaktike dhe teknologjike, të cilat janë të disponueshme për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Këto mjedise janë të përshtatura për të përmbushur kërkesat e lëndëve, duke mundësuar një formim teorik dhe praktik të studentëve. Po ashtu, fakulteti shfrytëzon laboratorët R26 dhe R22 pranë Rektoratit për lëndë specifike të programit.¹²⁶ Megjithatë, konstatohet se nuk ka ambiente të veçanta apo atelie për lëndët si vizatimi dhe muzika. Për të siguruar një formim profesional më të mirë për studentët që ndjekin arsimin parashkollor, Departamenti duhet të krijojë mjedise specifike për edukimin figurativ dhe muzikor. <i>Rekomandojmë që Fakulteti që mbulon këtë program studimi të</i>

¹²³ Tabele përmbledhëse për anakset (tabela nr.16). Evidenca nr.4

¹²⁴ " Tabele përmbledhëse për anakset (tabela nr.16). Evidenca nr.4

¹²⁵ Tabele përmbledhëse për kapacitetet infrastrukturore e FEF" Evidenca nr.3.18

¹²⁶ "Tabele përmbledhëse për kapacitetet infrastrukturore e FEF" Evidenca nr.3.18

	<i>krijojë ose përshtatë mjedise mësimore të përshtatshme për natyrën specifike të programit, si për vizatim, punë dore, ashtu edhe për muzikë.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Konfirmohet se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka në funksion dy laboratore informatikë të pajisura me kompjuterë, laptopë, smart borde, projektorë dhe paisje të tjera të nevojshme, të siguruara përmes projekteve të ndryshme. Këto laboratore kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve, në përputhje me objektivat e programit të studimit.			
Konkluzione	GVJ arrin në konkluzionin se institucioni disponon mjaftueshëm mjedise mësimore dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit, si dhe për formimin teorik dhe praktik, në përputhje me objektivat formuese të programit. Megjithatë, është e nevojshme që institucioni të mendojë edhe për krijimin e mjediseve specifike, të cilat kërkohen nga natyra e këtij programi studimi. <u>Rekomandojmë</u> që fakulteti që mbulon këtë program studimi të krijojë ose përshtatë mjedise mësimore të përshtatshme për natyrën specifike të programit, si për vizatim, punë dore, ashtu edhe për muzikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në Rregulloren e UNIKO-s (neni 71) dhe në programet e lëndëve, të cilat miratohen çdo vit akademik nga Departamenti i Edukimit (DE), në përputhje me udhëzimin Nr. 41, datë 24.01.2018, janë përcaktuar edhe elementët e formatit të programeve lëndore të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. Këtu përfshihet, ndër të tjera, literatura bazë dhe e rekomanduar që u ofrohet studentëve, qoftë fizike, ashtu edhe digjitale. Kjo literaturë është e disponueshme në bibliotekën e UNIKO-s dhe në bibliotekat e secilit fakultet, si në formë fizike ashtu edhe

	online, përmes burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Libraries), duke siguruar kështu qasjen në njohuritë e nevojshme për një formim profesional të studentëve. <i>Literatura që ofrohet në syllabuset e paraqitura në përgjithësi është e përditësuar me botime të viteve të fundit, por në disa syllabuse ka ende mundësi për përmirësim në këtë drejtim.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, siç konfirmohet edhe nga vizita në institucion, bën një përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e literaturës me botime të reja, përmes përcaktimit të një fondi për bibliotekën, në përputhje me kërkesat e Departamentit të Edukimit. Punonjësit e bibliotekës Shkencore të UNIKO-s dhe bibliotekës së FEF-së raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit dhe informojnë stafin akademik, personelin ndihmës-akademik dhe studentët mbi këto botime të reja përmes e-mail-eve zyrtare. Studentët janë të njohur me këtë informacion përmes vizitave fizike në bibliotekë, si dhe përmes përdorimit të bibliotekës virtuale, e cila është vënë në dispozicion të tyre. ¹²⁷
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në bibliotekën pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, rezulton se në dispozicion të studentëve, përveç literaturës bazë të çdo moduli, ofrohen edhe botime nga autorë vendas dhe të huaj. Këto materiale janë të depozituara gjithashtu në bibliotekën e UNIKO-s dhe janë të aksesueshme përmes EIFL (Electronic Information for Libraries), si dhe në formë elektronike në Platformën Microsoft Teams. ¹²⁸ Biblioteka siguron një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programeve të ndryshme studimi, duke përfshirë edhe ata të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" që mbulohet nga ky fakultet. Buxheti institucional parashikon fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat janë të disponueshme për studentët në aktivitetet e tyre hulumtuese për realizimin e detyrave të kursit, projekteve të lëndëve, si dhe punimeve të diplomës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra	Nga vizita në bibliotekën e FEF dhe nga verifikimi i fondit të librave që disponon kjo bibliotekë, rezulton se për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ekziston një fond i mjaftueshëm librash në shqip dhe në gjuhë të huaj, i cili është në përputhje me literaturën bazë dhe të rekomanduar të programeve të lëndëve, moduleve dhe

¹²⁷ Syllabuset e lëndëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Parashkollor". Evidenca 2.12

¹²⁸ "Tabele përmblidhëse e fondit të bibliotekave" Evidenca nr.3.16

apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	aktiviteteve mësimore të parashikuara në to. Biblioteka u ofron studentëve mundësinë për të shfrytëzuar gjithashtu fondin periodik, përfshirë gazeta dhe revista, si dhe për të përdorur librarinë elektronike për qasje në burime të tjera informacioni.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës, konstatohet se janë krijuar kushte të përshtatshme dhe ka akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e ambienteve dhe fondit të saj. Studentët mund të regjistrohen falas dhe të përdorin bibliotekën online, ku ata mund të kenë qasje në literaturë në gjuhë shqipe dhe të huaj. Përveç kësaj, studentët kanë akses dhe mund të përfitojnë nga burimet elektronike EIFL (Electronic Information for Libraries), dhe si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, kjo bibliotekë ka siguruar akses në burime të ndryshme elektronike. Këto informacione mund të shfrytëzohen nga çdo student pa pagesë. ¹²⁹
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në ambientet e bibliotekës së FEF rezulton se ka mjedise fizike të mjaftueshme dhe është e pajisur me programe kompjuterike (internet), video-projektorë dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve. Numri i konsiderueshëm i ambienteve të bibliotekës (2 salla me një sipërfaqe totale prej 100 m ²), si dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, mundësojnë shfrytëzimin e pa kufizuar të këtyre ambienteve nga të gjithë studentët. Sipërfaqja e konsiderueshme e ambienteve të bibliotekës dhe disponimi i pajisjeve kompjuterike sigurojnë akses të lirë dhe pa kufizime për studentët. ^{130/131}
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në faqen zyrtare të UNIKO dhe në ambientet e bibliotekës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF), janë të disponueshme oraret e bibliotekës, e cila qëndron e hapur çdo ditë nga ora 8:00 deri në 16:00. Për informacionin elektronik, orari i bibliotekës është nga ora 8:00 deri në 20:00. Në periudha provimesh, biblioteka ofron shërbime me orare të përshtatshme për studentët. Referuar RVB-së, kapaciteti i bibliotekës është për 1444 studentë dhe fondi i përgjithshëm përfshin 770 tituj, në gjuhën shqipe dhe të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht.

¹²⁹ "Rregullore e UNIKO" (neni 112) Evidenca 1.

¹³⁰ "Tabelë përmblledhëse e fondit të bibliotekës" Evidenca nr. 3.16

¹³¹ Tabelë përmblledhëse për anakset" (tabela nr.16) Evidenca nr.4

	Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 100 m ² dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve, të mbështetura nga një staf i specializuar dhe i trajnuar. ¹³²			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka studentore e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF) ka një bashkëpunim të mirë me strukturat e institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës, si dhe për përditësimin e këtij fondi dhe rritjen e nivelit të shfrytëzimit të tij. Buxheti institucional parashikon fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat vihen në dispozicion të studentëve për aktivitete hulumtuese, realizimin e detyrave të kursit, projekteve lëndore dhe punimeve të diplomës. Aktualisht, UNIKO ka fituar një fond prej 14,000,000 ALL, përmes thirrjes së AKKSHI-t për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor, që mbështet dixhitalizimin e Fondit të Bibliotekës Shkencore.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të siguruar literaturë bashkëkohore për studentët, si dhe për të krijuar një mjedis të përshtatshëm pune në bibliotekë, e cila ka disponuar një fond të mjaftueshëm librash, si në formë fizike ashtu edhe në rrugë dixhitale.</i> <i>Megjithatë, GVJ rekomandon se përditësimi i literaturës, veçanërisht asaj të rekomanduar në programet lëndore / syllabuset, duhet të jetë i pranishëm në të gjitha programet lëndore/syllabuset.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional

¹³² “Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës” Evidenca nr. 3.16

dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga dokumentet e paraqitura dhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se UNIKO ka një sistem të integruar për menaxhimin e informacionit për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve në një program studimi. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si njësi përbërëse e institucionit, administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët përmes një sistemi digjital të ri, "PITAGORA". Ky sistem është i integruar me rubrikat "Studentët" (Guida) dhe "Njoftime" në faqen zyrtare të institucionit, si dhe me platformën Microsoft Teams dhe sekretariatë mësimore. Ky sistem ofron mbështetje të plotë për procedurat e administratës, duke mbuluar të gjitha fazat e administrimit të dokumentacionit të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.^{133/134}
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, informacioni i lidhur me veprimtarinë akademike dhe kërkimin shkencor të stafit, si dhe administrimi i të dhënave të tjera, realizohet përmes një sistemi të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Ky sistem përbëhet nga struktura të ndryshme, si: <i>Departamenti i Edukimit</i>, i cili disponon informacionin lidhur me veprimtarinë akademike dhe kërkimin shkencor të stafit, sipas rregullores së tij. <i>Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore</i>, e cila arkivon një bazë të plotë të dhënash për procedurat e punësimit, kuadrin ligjor, dokumentacionin përkatës dhe marrëveshjet e nënshkruara. <i>Drejtoria e Financës</i>, që përditëson informacionin mbi stafin akademik dhe administrativ, duke siguruar të dhënat për kategoritë e punonjësve, ngarkesën mësimore dhe të gjitha informacionet lidhur me pagat, honoraret, kontributet dhe shpërblimet e tjera. <i>Sekretaria mësimore</i>, e cila administron të dhëna fizike dhe dixhitale për studentët¹³⁵ dhe mbikëqyr tërë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin e pedagogëve. Për më tepër, sistemi PITAGORA pranë FEF, si pjesë e

¹³³ Manual i përdorimit të PITAGORA" Evidenca Nr.1.6

¹³⁴ Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>

¹³⁵ Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore".Evidenca Nr.1.4.)

	veprimtarisë së sistemit të UNIKO-s, publikon të dhëna të lidhura me programin e studimit, të cilat janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UNIKO-s dhe njësive përkatëse. Ky sistem ofron informacion dhe dokumente për pedagogët dhe studentët. Gjatë regjistrimit në sistem, personeli akademik dhe studentët pajisen me një llogari unike dhe fjalëkalim për përdorimin e saj. Manuali për përdorimin e sistemit PITAGORA lehtëson përdorimin e tij nga studentët dhe stafi akademik. ¹³⁶
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UNIKO, përmes shërbimeve dixhitale të mundësuar nga platforma "PITAGORA", ofron akses në informacione të ndryshme dhe mundëson komunikimin interaktiv në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik. Kjo platformë lejon marrjen e informacionit në kohë reale nga studentët, ofron shërbime më efikase sekretarie dhe lehtëson komunikimin ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, rezulton se komunikimi mes tyre zhvillohet gjithashtu përmes rrjeteve sociale, paketës Office 365 dhe adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. ¹³⁷
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në rregulloren e SKVIA (neni 13) dhe të NJSBC, janë përcaktuar qartë detyrat e saj për monitorimin e procesit mësimor, sigurimin e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e raporteve vjetore lidhur me ecurinë e këtij procesi. ¹³⁸ Po ashtu, sekretaria mësimore pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, përmes platformës PITAGORA, siguron evidentimin në kohë reale të të dhënave të lidhura me veprimtarinë mësimore të pedagogëve dhe vlerësimin e studentëve. Kjo mundëson që strukturat dhe autoritetet drejtuese të identifikojnë mangësitë ose mosrespektimin e afateve të përcaktuara në rregulloren e studimit të programit. Bazuar në informacionin e mbledhur herë pas here, bëhen përpjekje për vlerësimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të stafit, dhe materiali përkatës i vihet në dispozicion drejtorit të fakultetit dhe më pas edhe zv. Rektorit për mësimin. ¹³⁹
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin	Nga verifikimi në faqen zyrtare të UNIKO-së, mund të konfirmohet se janë të publikuara informacione lidhur me Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF), përfshirë misionin

¹³⁶ Manual i përdorimit të PITAGORA" Evidenca Nr.1.6.

¹³⁷ Raport instalimi i projektit Office 386". Evidenca 2.32

¹³⁸ Rregullore e organizimit dhe e funksionimit të SKVIA" (NJSBC).Evidenca 1.5

¹³⁹ " Rregullore e organizimit dhe e funksionimit të SKVIA" (NJSBC).Evidenca 1.5; "Manual sistemi elektronik Pitagora" Evidenca nr.1.6.1.

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	dhe vizionin e tij, veprimtaritë, programet e studimit, si dhe informacionin që lidhet me programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor", duke përfshirë planin mësimor, lëndët, skedën e programit, etj. ¹⁴⁰			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Institucioni disponon sistemin "PITAGORA" nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit;</i> <i>Sistemi ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB-së, rezulton se buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës, nën drejtimin e administratorit të UNIKO-së, në përputhje me rregulloren financiare, dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. ¹⁴¹ Në takimin me Drejtorin e njësisë bazë, u theksua se hartimi i buxhetit të universitetit fillon nga njësia bazë, pra nga departamenti, duke marrë parasysh nevojat për realizimin e secilit program studimi. ¹⁴² Në rregulloren e shpërndarjes financiare të institucionit (neni 6), janë përcaktuar kriteret e financimit për çdo njësi kryesore dhe për programet e studimit. Gjithashtu, raporti i analizës mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare siguron transparencë financiare dhe mundëson që njësia bazë (Departamenti i Edukimit) të jetë pjesë e proceseve vendimmarrëse. ¹⁴³

¹⁴⁰ Faqja zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al>

¹⁴¹ Rregullore e Drejtorisë Ekonomike" Evidenca nr. 1.7.

¹⁴² Rregullore financiare e shpërndarjes së të ardhurave në UNIKO" Evidenca nr.1.8.1.

¹⁴³ Rraport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO" Evidenca nr.2.8.

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit gjatë vizitës në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF), rezulton se plani i financimit për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin parashkollor” i ofruar nga Departamenti i Edukimit, nuk është i ndarë veçmas, pasi hartohet për institucionin në tërësi, duke përfshirë katër fakultetet. Nga analiza e buxhetit të institucionit, konstatohet se plani financiar është i ndarë sipas strukturës që i përshatet zërave të ndryshëm të financimit, të cilët përfshijnë: financimin e burimeve njerëzore (paga, shpërblime), shpenzime operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe mjediseve (p.sh., rikonstruksioni i godinës), shpenzime për pasurimin e literaturës në përputhje me kërkesat e programeve të studimit, mbulimi i kostove për personelin akademik efektiv (PAE) dhe personelin ndihmës akademik (PAK), si dhe shpenzime për bibliotekën online.^{144/145}
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB-së, rezulton se zbatimi i buxhetit është objekt kontrolli nga tri hallka kryesore: Auditimi i brendshëm financiar, i realizuar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit; Auditimi i jashtëm, i kryer çdo dy vjet nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; dhe Auditimi i jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. <i>Megjithatë, nuk rezulton se ka një njësi të dedikuar për auditimin dhe nuk janë të disponueshme raporte specifike auditimi.</i> Në analizën vjetore të UNIKO-së, diskutohet dhe miratohen raportet që lidhen me planin njëvjeçar dhe afatmesëm të institucionit.¹⁴⁶
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Konfirmohet se Administratori i UNIKO-së, sipas Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", paraqet çdo vit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit raportin për realizimin e buxhetit të vitit, sipas zërave përkatës, ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit. Ky raport i dërgohet

¹⁴⁴ Rregullore e Drejtorisë Ekonomike” Evidenca nr.1.7.

¹⁴⁵ Rregullore financiare e shpërndarjes së të ardhurave në UNIKO” Evidenca nr.1.8.1.

¹⁴⁶ Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO” Evidenca nr.2.8.

	gjithashtu Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) dhe bëhet i njohur për të gjitha njësitë e institucionit.¹⁴⁷ <i>Në raportin vjetor të buxhetit, theksohet se çdo vit organizohen takime të hapura, në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve për të diskutuar realizimin e buxhetit, por nuk ka dokumentacion të disponueshëm që të vërtetojë këto takime.</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me buxhetin dhe burimet e financimit në UNIKO, si dhe nga takimi me drejtues të institucionit, konfirmohet se institucioni siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë, Departamentit të Edukimit. Gjithashtu, UNIKO ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, duke u mbështetur në grantin që merr nga buxheti i shtetit, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që ofron, si dhe të ardhurat nga projektet.¹⁴⁸			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UNIKO garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e programit të studimit, duke pasqyruar këtë në gjendjen financiare të institucionit, siç është paraqitur në raportet financiare vjetore.</i> <i>Sugjerojmë se institucionin duhet të krijojë një zyrë auditimi, nëse plotësohen kriteret, dhe të pasqyrojë më mirë veprimtarinë që lidhet me auditimin. Standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁴⁷ Statuti i UNIKO "Evidenca nr.1.1

¹⁴⁸Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO" Evidenca nr.2.8.

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, rezulton se UNIKO zbaton politika të qarta dhe funksionon me njësi të cilat disponojnë informacion të detajuar për studentët mbi ecurinë e ciklit të plotë akademik të tyre. Ky informacion përfshin kriteret e pranimi, regjistrimin e studentëve, kohëzgjatjen e studimeve, njohjen e krediteve, transferimin e studimeve, si dhe lëshimin e diplomës. Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor" operon në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për institucionet e arsimit të lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, të pasqyruara në: Statutin e UNIKO-së (Kreu VI, Nenet 51, 52, 55, 64, 66, 70, 71) dhe Rregulloren e Universitetit (Kreu VI, Nenet 41, 42, 43, 45, 46). ^{149/150}
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në UNIKO dhe Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, si përgjegjëse e programit të studimit, mund të konfirmojmë se zbatohen procedura transparente për pranimin dhe trajtimin e studentëve gjatë viteve të studimeve në ciklin e parë të studimeve. Bazuar në Statutin e UNIKO, Kreu VI, Neni 55 dhe Rregulloren e FEF, pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë realizohet në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe MAS për vitin akademik përkatës. Këto programe mund të ndjekin shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetërorë dhe shtetas të huaj, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara, pa dallim gjinie, moshe, origjine ose etnie. ¹⁵¹
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, në përputhje me propozimin e njësisë bazë, Departamentit të Edukimit, harton dhe paraqet për miratim në Senatën Akademik çdo vit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për programin e studimeve Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor". Ky proces bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e UNIKO (Kreu VI, Neni

¹⁴⁹ "Statuti i UNIKO" Evidenca nr. 1.1

¹⁵⁰ Rregullore e UNIKO" Evidenca 1.2.

¹⁵¹ "Statuti i UNIKO" Evidenca nr. 1.1.

Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	55), Rregulloren e UNIKO (Kreu VI, Neni 69), dhe Rregulloren e FEF (Kreu V, Neni 46). ¹⁵² Megjithatë, për shkak të natyrës së programit, nuk janë përcaktuar kritere specifike të tjera. Pas miratimit të këtyre kritereve nga MAS, ato publikohen në faqen zyrtare të UNIKO-së. ¹⁵³
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", disponon një sistem të mirëorganizuar informimi për studentët dhe të interesuarit në lidhje me procedurat e pranimiit dhe informacionet për vlerësimin, transferimin ose ekuivalentimin e studimeve të mëparshme. Këto procedura janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimit (nenet 45, 46 dhe 59 deri 65) dhe në Rregulloren e Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". ¹⁵⁴ Nëpërmjet Zyrës së Informimit për Studentët, Sekretarisë Mësimore (në formë shkresore dhe elektronike) dhe faqes zyrtare të UNIKO (në rubrikën Studentët), janë të aksesueshme të gjitha procedurat e pranimiit dhe konkurimiit. Gjithashtu, nëpërmjet Platformës Pitagora, studentët mund të njihen online për përparimin e tyre në kohë reale. ¹⁵⁵
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nga verifikimi në faqen zyrtare të UNIKO-së (www.unkorce.edu.al) dhe në dokumentacionin e paraqitur gjatë vizitës në institucion, rezulton se UNIKO ofron informacion të plotë në gjuhën shqipe dhe angleze për kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në këtë institucion. Ky informacion përfshin detaje mbi programet e studimit, kriteret e pranimiit, si ato të përgjithshme ashtu dhe të veçanta nëse ka, si dhe informacion mbi organizimin e programit dhe përmbajtjen e Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor". ¹⁵⁶ Gjithashtu, ka një bashkëpunim të ngushtë mes njërive kryesore të institucionit dhe Qendrës së Karrierës, e cila realizon çdo vit një fushatë promovuese për programet e studimit dhe përgatitjen e udhëzuesit të Universitetit.
Kriteri 6. Institucioni	Nga informacioni i marrë nga vendimet e Senatit, rezulton se

¹⁵² Statuti I UNIKO " Evidenca nr. 1.1; " Rregullore e UNIKO" Evidenca 1.2.

¹⁵³ Faqja zyrtare e UNIKO (kriteret e pranimiit) <https://unkorce.edu.al/ep-content/uploads/2023/06/Kriteret-e-pranimiit-2024-2025-1.pdf>

¹⁵⁴ Rregullore e Programit studimit AP" .Evidenca 2.4.

¹⁵⁵ Manuali i përdorimit të sistemit Pitagora"Evidenca nr.1.6.1.

¹⁵⁶ "Faqja zyrtare e UNIKO" <https://unkorce.edu.al>

harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UNIKO harton çdo vit akademik kriteret për pranimin në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Ky proces nis me propozimin e njësisë bazë, miratimin e këtyre kriterëve dhe kuotave për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicat dhe shtresat e marginalizuara, dhe përfundon me miratimin nga MAS. Kriteret dhe kuotat përkatëse bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. ¹⁵⁷			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në Rregulloren e UNIKO, <i>neni 46, pika 2.b</i> , konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, si dhe studentët jashtë vendit, pas ekuivalentimit të diplomës. ¹⁵⁸			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në takimin me Drejtorinë e Financave të UNIKO-së dhe me studentët, u konfirmua se çdo vit akademik, institucioni publikon informacion mbi kriteret dhe procedurën e aplikimit për bursa studimi, si dhe mundësinë e përjashtimit nga tarifa shkollore, për të mbështetur studentët që vijnë nga shtresat në nevojë. ^{159/160}			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të qarta për pranimin, përzgjedhjen, përparimin, transferimin dhe njohjen e krediteve të studentëve, si dhe për vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>Institucioni zbaton politika mbështetëse për studentët që vijnë nga shtresa në nevojë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

¹⁵⁷ Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimin të studentëve 2024. <https://unkorce.edu.al>

¹⁵⁸ Rregullore e UNIKO" Evidenca 1.2.

¹⁵⁹ Njoftimi mbi fitimin e bursave" Evidenca nr.3.22.

¹⁶⁰ <https://ëëë.facebook.com/share/p/15fmxDZuGQ/>

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga evidencat e paraqitura dhe vizita në institucion, rezulton se UNIKO, përmes strukturave të përcaktuara si Departamenti i Edukimit, Zyrës së Informimit të Studentëve, Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Programit, ofron informacion të vazhdueshëm për studentët e programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin parashkollor” në lidhje me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm në rregulloret e institucionit dhe të njësisë kryesore, të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.¹⁶¹ Informimi i studentëve bëhet edhe nga pedagogët e lëndëve gjatë prezantimit të syllabuseve dhe planit mësimor, si dhe përmes platformës Pitagora, që është e aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.¹⁶²
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e studimeve të UNIKO (neni 60), Rregulloren e FEF (neni 66) dhe Rregulloren e programit të studimit të AF (Transferimet e studimeve), janë përcaktuar kriteret dhe procedurat që lidhen me njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimin e studimeve.¹⁶³ Në këtë kuadër, ngrihet një komision ad-hoc që vlerëson numrin e krediteve që mund t'i njihen studentit, si dhe u konfirmua një rast konkret gjatë takimit me studentët.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se UNIKO dhe FEF, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin parashkollor”, disponojnë një sistem të strukturuar informimi për studentët. Ky sistem mundëson që ata të njoftohen që në ditën e parë të mësimin për lëndët që përmban kurrikula, për përmbajtjen e tyre, si dhe për kriteret e vlerësimit që janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, në rregulloret e studimit të institucionit, njësisë kryesore, dhe rregulloren e programit të studimit.¹⁶⁴ Gjatë takimit me studentët, u konfirmua se ata merren informacion mbi vlerësimin e tyre edhe përmes sistemit Pitagora.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	Në fillim të vitit të tretë të studimeve, studentët marrin informacione të hollësishme pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit, dhe pedagogut udhëheqës për kriteret dhe procedurat e punimit të

¹⁶¹ <https://unkorce.edu.al>. (Studentet Informacion i përgjithshëm.)

¹⁶² Manual përdorimi të sistemit PITAGORA.Evidenca Nr. 1.6.1

¹⁶³ Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 60” Evidenca nr.1.1; Rregullore e Programit të studimit AP (2023-2026).Evidenca 2.4.

¹⁶⁴ “ Syllabuset e lëndëve” Evidenca 2.12; “ Rregullore e UNIKO,FEF dhe Programit studimiAP” Evidenca.nr1.2 ; 2.1;2.4;

punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	diplomës dhe provimit të formimit. Kriteret dhe procedurat përgatitore për provimin me shkrim dhe temën e diplomës janë të pasqyruara në rregulloret e institucionit (Rregullore e UNIKO, neni 89; 90; Rregullore e Programit AF, Kreu 14) dhe janë të aksesueshme për të gjithë.¹⁶⁵			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në faqen zyrtare të UNIKO, (rubrika Studentët), është e aksesueshme tërë veprimtaria e Qendrës së Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit, lidhur me informimin periodik të të gjithë maturantët dhe studentët e ardhshëm në lidhje me programin e studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin parashkollor”. Gjithashtu, institucioni publikon Guidën studentore, rrjetet sociale dhe javën e informimit, ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program.¹⁶⁶			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi:</i> <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh.</i> <i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, dhe përmbylljes së tyre me punim diplome apo provim diplomimi.</i> <i>Institucioni realizon një numër aktiviteteve dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	Nga takimi me studentët, u konfirmua se nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni, si dhe njësive të tjera ndihmëse dhe

¹⁶⁵ “ Rregullore e UNIKO; Rregullore e programit AP”.Evidenca Nr.1.2 ; 2.4.

¹⁶⁶ Material promovuese broshura për promovimin”.Evidenca nr.3.24

hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	pedagogëve, ata marrin informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit të studimit gjatë paraqitjes së syllabuseve.¹⁶⁷ Për studentët e rinj informimi i tyre lidhur me strukturën, dhe organizimin e programit dhe infrastrukturën në dispozicion të tyre bëhet sipas planifikimit të departamentit në javën e parë të vitit akademik në bashkëpunim me QKA-në, ndërsa për studentet e viteve të tjera ë fillim të çdo semestri, pedagogët titullarë të lëndëve të programit të studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor" informojnë studentët për organizimin përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu në faqen zyrtare të UNIKO në rubrikën "Studentet" publikohet "Guida e studentëve" jepet një informacion i plotë lidhur me institucionin dhe programet e studimit që ai ofron.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, në përputhje me rregulloret e UNIKO-së, ka përcaktuar një kompleks përgjegjësish për të gjitha strukturat ndihmëse, si Qendra e Karrierës dhe Alumni, Platforma Pitagora dhe rrjetet sociale, për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor". Në takimin me studentët, ata deklaruan se mermin informacion jo vetëm nga pedagogët dhe sekretaria mësimore, por edhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UNIKO s.¹⁶⁸
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Konfirmojmë se, gjatë takimeve informuese me studentët e programit të studimit "Bachelor" të Departamentit të Edukimit, kjo njësi, në bashkëpunim me QKA, në fillim të çdo viti akademik, informon studentët lidhur me fushat dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të programit të studimit. Po ashtu, publikon për të gjithë të interesuarit njoftime mbi vendet e lira të punës, të cilat janë të aksesueshme në faqen zyrtare të UNIKO-së, si dhe në faqen e saj në Facebook.¹⁶⁹
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", UNIKO ka krijuar një sistem menaxhimi efektiv që përfshin Sekretarinë Mësimore, QKA, grupet e lëndëve, Sektorin e Studimeve, TIK, dhe faqen zyrtare të institucionit. Ky sistem i mundëson studentëve akses në informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin e studimit. Gjatë vizitës u konstatua se institucioni ka siguruar një

¹⁶⁷ Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>. (Studentet Informacion i përgjithshëm.)

¹⁶⁸ " Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>

¹⁶⁹ Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al> (QKA)

shërbimet në funksion të realizimit të tij.	infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e këtij programi.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se UNIKO ka krijuar dhe ka në funksion një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit, i cili përfshin detaje lidhur me programet e studimit të ofruara, stafin akademik, kurrikulën, rezultatet e të nxënit, kurset dhe rezultatet e provimeve. Të gjitha këto janë të disponueshme në llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora. Ky sistem mundëson që studentët të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacionin për veprimtarinë mësimore gjatë periudhës së studimeve, regjistrimet në provime, rezultatet e vlerësimit, të dhënat për lëndët, mjetet didaktike dhe tekstet. ¹⁷⁰			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit V.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se:</i> <i>Institucioni ka një sistem efektiv të informimit të studentëve për tërë aspektet e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit në Sekretarinë mësimore dhe "Rregullores së Sektorit të Studimeve dhe TIK" rezulton se FEF disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për herë të parë dhe atyre që diplomohen. ¹⁷¹ Statistika vjetore për studentët e diplomuar mban dhe FEF pasqyrohen në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore kërkimore të tij. ¹⁷²

¹⁷⁰ Faqe zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>

¹⁷¹ Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK" Evidenca nr.1.10; Vizita në sekretarinë mësimore. (Referuar regjistrat të përparimit të studentëve dhe regjistri i diplomimit)

¹⁷² Raport vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të FEF 2023-24," . Evidenca.Nr.2.9

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion, në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e diplomave, si dhe të sistemit PITAGORA, rezulton se Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” me statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi.¹⁷³ Në këto statistika jepet edhe numri i të larguarve, të transferuar apo edhe të çrregjistruar. Në analizën vjetore të Fakultetit evidentohen për çdo program numri i të regjistruarve, cilësia në hyrje, si dhe numri i të diplomuarve dhe cilësia në dalje.¹⁷⁴ Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit. Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për tre vite akademike janë: Viti akademik 2022-2023—13 studentë; Viti akademik 2023-2024—15 studentë; Viti akademik 2024-2025—14 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësi, si dhe aktivitetit të sektorëve të këtij institucioni si Sektori i Studimeve dhe TIK, Sekretarisë mësimore dhe Platformës Pitagora, rezulton se këto njësi menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit dhe i kanë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit.¹⁷⁵ UNIKO, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, ka miratuar Rregulloren për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.¹⁷⁶
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të	Në Statutin e UNIKO (neni 84) dhe në "Raportin e kontrollit të dokumentacionit mësimor" rezulton se është parashikuar kontrolli periodik nga njësia SKVIA, e cila menaxhon programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin parashkollor” dhe programet e tjera. Kjo njësi bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, merr feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, bën analizë të gjendjes dhe harton një

¹⁷³ Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK” Evidenca nr.1.10 ;Verifikime ne sekretarine mësimore të dokumentacionit.

¹⁷⁴ Raport vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të FEF 2023-24”, . Evidenca.Nr.2.9

¹⁷⁵ Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK” Evidenca 1.10

¹⁷⁶ Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale” Evidenca nr.1.9




informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	raport, <u>por nuk rezulton se ka një plan pune të formalizuar për përmirësimet e mundshme.</u> ¹⁷⁷											
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojmë se njësia kryesore FEF dhe njësia bazë DE, që mbulon programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ka një dokumentacion të detajuar lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje. Ky informacion verifikohet në dokumentacionin e Sekretarisë Mësimore dhe në raportet e analizës vjetore të punës mësimore dhe shkencore të njësisë. Të dhënat për cilësinë në hyrje të studentëve jepen si më poshtë.¹⁷⁸ <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Mesatarja në hyrje</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>7,3</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>7,3</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>7,1</td></tr></table>				Viti akademik	Mesatarja në hyrje	2022-2023	7,3	2023-2024	7,3	2024-2025	7,1
Viti akademik	Mesatarja në hyrje											
2022-2023	7,3											
2023-2024	7,3											
2024-2025	7,1											
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka të dhëna të plota dhe të organizuara për studentët, duke përfshirë numrin dhe profilin e tyre gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe pas diplomimit, duke i angazhuar ato në sektorin e Alumnit.</i> <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i> <i>Departamenti i Edukimit përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</i>											
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht								
				X								

¹⁷⁷Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor.Evidenca Nr.2.31

¹⁷⁸ "Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore De, 2023-2024. Evidenca nr.2.10

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Statutin e UNIKO (<i>Kreu VIII, Neni 79, Pika 2</i>) dhe rregulloret e fakultetit (<i>Kreu VII, neni 99 dhe 100, pika 1</i>), studentët përfshihen në organet vendimmarrëse si në: - Senatin Akademik; - Njësinë për Sigurimin e Cilësisë; - GVB-të; - Këshilli studentor; - shoqata dhe forume studentorë;^{179/180} Nga takimi me studentët u konfirmua se ata janë të organizuar në Këshillat Studentore në nivel njësie kryesore dhe institucioni, dhe veprimtaria e tyre rregullohej sipas përcaktimeve të Rregullores së Këshillit Studentor.¹⁸¹
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UNIKO si institucion dhe FEF si njësi përgjegjëse për programin e studimit ka një përfshirje të konsiderueshme të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe përpiqen të angazhojnë ata në përmirësimin e aktivitetit të institucionit. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik të UNIKO me një përqindje prej 10% të numrit të anëtarëve të Senatit; në Këshillin e Etikës të UNIKO; në NJSBC në nivel institucional dhe fakulteti; në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe Komisionin e Zgjedhjeve në Fakultet (KZF).¹⁸² Nga takimi me studentët, u theksua se ata përmes pyetësorëve, të cilët përdoren për të dhënë mendime mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, si dhe përfaqësuesve të tyre në Këshillin Studentor, shprehin mendime dhe propozime për problemet që lidhen me rregulloret e veprimtarisë mësimore, cilësinë e shërbimeve, dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive.¹⁸³
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton	Bazuar në dokumentacionin e publikuar në faqen zyrtare të UNIKO dhe shqyrtimit të "Rregullores për organizimin dhe

¹⁷⁹ "Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF". Evidenca_Nr.2.1)

¹⁸⁰ "Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.Evidenca Nr.1.1)

¹⁸¹ Rregullorja e këshillit studentor" Evidenca nr.1.17

¹⁸² "Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese" Evidenca nr.1.18.

¹⁸³ Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF" Evidenca nr. 2.1

përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	funksionimin e DKVI-së" (<i>Kreu IV, neni 13; Kreu V pika 2</i>) dhe "Rregullores së organizimit të zgjedhjeve të Këshillit Studentor", si dhe sektorëve përgjegjës mbi ecurinë e procesit mësimor, rezulton se gjatë tërë vitit akademik realizohen kontrolle të rregullta në programet e studimit që mbulon kjo njësitë, me instrumente që sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe këto pasqyrohen në raportin vjetor të sektorit apo të njësisë.¹⁸⁴ Studentët, përmes Këshillit Studentor të Fakultetit, japin mendime dhe sugjerime për programin e studimit në takime që organizohen nga ky Këshill me Dekanin e FEF. Sipas drejtuesve të njësisë, ndryshimet e realizuara në programin e studimit janë edhe rezultat i sugjerimeve të dhëna nga studentët.¹⁸⁵			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka sanksionuar në "Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti 'Fan S. Noli'" (<i>neni 69; 83-93</i>) barazinë dhe ndershmërinë në vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit dhe të rishikimit të vlerësimit.¹⁸⁶ Nga takimi me studentët u konfirmua se ato kanë mundësinë e ankimimit dhe i njohin procedurat që ndiqen lidhur me këtë problem, dhe kishte raste kur rezultati i provimit të tyre ishte rishikuar nga komisioni i ngritur nga dekanati.			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se UNIKO dhe FEF ka garantuar përfshirjen e studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse dhe ka marrë në konsideratë mendimet e tyre për përmirësimin e programeve të studimit që ajo ofron.</i> <i>Në Departamentin e Edukimit, në protokollin e saj, kishte edhe sugjerime të dhëna nga studentët dhe reflektime në ndryshimet e bëra në strukturë apo përmbajtjen e programit mësimor. Standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

¹⁸⁴ "Rregullore e organizimit dhe funksionimit të DKVI-së" Evidenca Nr. 1.5; "Rregullore e Këshillit studentor" Evidenca nr. 1.17.

¹⁸⁵ Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA. Evidenca nr.2.23

¹⁸⁶ "Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF" Evidenca_Nr.2.1



Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar gjatë vizitës në institucion, rezulton se UNIKO si institucion ka vënë në dispozicion të studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor" njësi shërbimi dhe informimi për studentët, si: Sistemi Pitagora, Sektori Mësimor dhe TIK-u, Programi i Transparencës i instaluar në faqen zyrtare (i cili pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve); Paketën Office 365 (për komunikim nëpërmjet adresave elektronike staf-student); broshura promocionale (Guida e studentëve) etj. ^{187/188}
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Rezulton se UNIKO ka një sistem të vendosur informimi dhe këshillimi për studentët që mbulon tërë veprimtarinë mësimore dhe administrative, duke e mbështetur këtë me rregullore të njëjësive përkatëse mbështetëse të studentëve si Sektori Mësimor dhe TIK, faqen zyrtare të institucionit, koordinatorin e programit (ndonëse efektiviteti i tij tek studentët nuk ishte shumë i dukshëm), dhe rrjetet sociale (Facebook dhe Instagram). ¹⁸⁹ Për ndjekjen dhe marrjen e informacionit mbi përparimin e studentëve, funksionon platforma Pitagora, ku studentët rregjistrohen nga sektori i IT.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	Nga takimi me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, e cila përfshin edhe Qendrën e Karrierës dhe Alumni, rezulton se kjo njësi bashkëpunon me Sektorin e Studimeve, Sektorin e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, dhe Sektorin e Informacionit dhe Promocionit. Ajo punon për hartimin dhe nxjerrjen e broshurave dhe fletëpalosjeve që lidhen me informimin dhe këshillimin e studentëve mbi procesin mësimor, problemet që lidhen me

¹⁸⁷ " Faqja zyrtare e UNIKO . <https://unk.pitagora.rash.al/>

¹⁸⁸ Raport Instalimi i projektit OFFICE 365.Evidenca nr.2.32.

¹⁸⁹ Faqja zyrtare UNIKO (ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit, <http://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf>, <https://ëëë.unkorce.edu.al/tarif-e-sherbimeve>, <https://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/Studentet%20qe%20perjashtohen%20nga%20tarifat.pdf>, <https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643>, <https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419>.

posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	praktikën mësimore, dhe në mënyrë të veçantë orientimin e studentëve për tregun e punës. ¹⁹⁰			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimi me studentët rezultoi se Qendra e Karrierës dhe Alumni menaxhon Rrjetin Alumni, i cili ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të studentëve të diplomuar në UNIKO. Ajo krijon kontakte me punëdhënësit potencialë për të promovuar studentët në kërkim të mundësive të reja të punësimit. Në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit, SKVIA organizon trajnime dhe aktivitete të ndryshme me studentët, ku diskutohet dhe orientohen studentët mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve dhe përpilimin e dosjes personale, si dhe prezantimin gjatë intervistave të punës, etj. Qendra gjithashtu njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Zyra e Punës. ¹⁹¹			
Konkluzione	GVJ mendon se institucioni, nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni, realizon informimin dhe këshillimin e studentëve për veprimtarinë e tyre mësimore dhe për karrierën në mënyrë periodike, përmes aktiviteteve që organizon dhe publikimeve në faqen zyrtare të UNIKO. Njësia bazë që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

¹⁹⁰ Faqe zyrtare e UNIKO. <http://ëëë.unkorce.edu.al>

¹⁹¹ Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA-së" Evidenca nr.3.25

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se institucioni UNIKO, në kuadër të projektit TEAVET, ka hapur Qendrën e Formimit të Vazhduar me 39 module trajnimi dhe ka hartuar një manual për përgatitjen dhe korrigjimin e provimeve në Clean Score dhe Microsoft Teams. ^{192/193} Përdoren platforma të ndryshme për ofrimin e mësimin dhe vlerësimin e dijeve online, si Google Meet/ Classroom, Zoom, <u>por nuk rezulton se ka një udhëzues për përdorimin e metodave inovative ose evidencë të realizimit të ndonjë trajnimi.</u> Në RVB jepet si manual përdorimi platforma Pitagora, por kjo platformë nuk ka lidhje me metodat e mësimdhënies.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësia kryesore dhe vizita e bërë në institucion, rezulton se institucioni dhe strukturat përgjegjëse për programin e studimit kanë në funksionim të vazhdueshëm mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor të programit. Në rregulloren e funksionimit të DKVI-së janë të përcaktuara qartë detyrat e NJSBC për një vazhdimësi të monitorimit të procesit të mësimdhënies. Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm, i cili zhvillohet nga NJSBC në bashkëpunim me këshillin studentor. ¹⁹⁴ Departamenti dhe NJSBC përdorin instrumentë vlerësues si pyetësorë me studentët. Vlerësimi bëhet në kuadër të arritjeve në fushën akademike dhe kërkimore të gjithsecilit, nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli dhe gjatë analizave vjetore të departamentit, sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë. ¹⁹⁵
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Departamenti i Edukimit, në përputhje me rregulloret e studimit, kanë garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Përdorimi i instrumentave të tillë si pyetësorët me studentët nga SKCS-ja në bashkëpunim me NJSBC-në për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi, në fund të çdo semestri, si dhe pyetësorët me

¹⁹² "Model testimi Clean Score". Evidenca_Nr.2.21

¹⁹³ "Manual I mësimin Online" Evidenca nr.3.18

¹⁹⁴ "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI". Evidenca_Nr.1.5)

¹⁹⁵ Manuali i cilësisë UNIKO fq. 32-35". Evidenca_Nr.1.16.

trajtimin të ankimeve.	studentët nga pedagogët e çdo lënde, në përfundim të çdo semestri, ka për qëllim vlerësimin e performancës së pedagogut nga ana e studentëve. Këto instrumenta tregojnë për një përfshirje të studentëve në këtë proces. ¹⁹⁶ Bazuar në këto të dhëna, hartohen edhe raportet e vlerësimit të brendshëm, të cilat janë raporte periodike vjetore dhe ofrojnë informacion për zhvillimet gjatë një viti akademik, duke përfshirë fushat prioritare. ¹⁹⁷
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	UNIKO dhe FEF, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, mbledhin të dhëna lidhur me sigurimin e cilësisë nga Sektori i Kurrikulës, i cili përfshin edhe Qendrën e Karrierës dhe Alumni. Siç është përmendur më parë, ato vazhdimisht përdorin mjete dhe teknika të ndryshme për të vlerësuar përparimin e studentëve dhe procesin mësimor. Në analizën vjetore të punës të FEF për vitin akademik 2023-2024, bëhet një analizë e gjetjeve nga rezultatet e testeve të bëra me studentët nga njësitë e sigurimit të cilësisë. ¹⁹⁸ <i>GVJ sugjeron që FEF apo edhe UNIKO rezultatet dhe analizat e bëra së bashku edhe me plane të punës për përmirësimin e mangësive të bëjnë publike. Ky hap do të sigurojë më shumë transparencë dhe do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të studentëve.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe nga vizita në institucion, si dhe nga takimi me stafin, rezulton se institucioni përdor një sërë formash përfshirje të stafit në kualifikime që organizohen. Megjithatë, nuk ka evidencë të tjera që flasin për promovimin e praktikave të mira apo për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies për stafin akademik. <i>Në këtë kontekst, rekomandojmë që promovimi i praktikave të mira dhe inkurajimi i përmirësimit të mësimdhënies të ketë një spektër më të gjerë.</i> Kjo mund të përfshijë aktivitete të tilla si seminare të përhershme për zhvillimin profesional, mundësi për pjesëmarrje në konferenca dhe ërkshop-e ndërkombëtare, si dhe krijimin e mundësive për të ndarë eksperiencë dhe metoda të reja mësimdhënieje mes kolegëve. Ky përmirësim do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe do të motivonte stafin akademik për të përmirësuar vazhdimisht performancën e tij.
Konkluzione	<i>GVJ mendon se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ndjek një</i>

¹⁹⁶ Model analize në përfundim të një moduli" Evidenca nr.2.28. " Faqe zyrtare UNIKO-së." Pyetësor studentor.

¹⁹⁷ Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare 2022-2023, UNIKO" Evidenca Nr. 2.8

¹⁹⁸ Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA" Evidenca nr. 2.23.

	<i>politikë të garantimit dhe promovimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të praktikave të mira, por duhet të punojë për të zgjeruar këtë spektër në mënyrë që të mundësojë një përfshirje më të gjerë të stafit dhe të krijojë mundësi të tjera për zhvillimin e praktikave inovative. Kjo përfshin krijimin e udhëzuesve për metodat inovative në mësimdhënie dhe zgjerimin e mundësive për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, përfshirë organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve që nxisin kreativitetin dhe përmirësimin e teknikave të mësimdhënies.</i> <i>Për këtë arsye, rekomandojmë që të punoni më shumë në këtë drejtim për të krijuar udhëzues të qartë dhe materiale mbështetëse që do të inkurajonin stafin akademik të përdorë metodat më të reja dhe inovative në procesin mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, konfirmohet se UNIKO ka një strukturë të plotë për sigurimin e cilësisë, e cila është e organizuar në nivele të ndryshme, duke përfshirë fakultetin dhe institucionin në tërësi. Struktura për sigurimin e cilësisë përfshin Senatin akademik, Sektorin e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (SKVIA), dhe njësitë bazë të UNIKO-së, si dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi. Këto struktura punojnë sipas një manuali të cilësisë që është në funksion në shkallë institucionale ¹⁹⁹ dhe organizojnë takime periodike për përmirësimin e programeve të studimit. Gjetjet nga pyetësorët që realizohen në fund të lëndëve dhe moduleve janë pjesë e analizës dhe përdoren për të identifikuar mundësi për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe përmbajtjes së programeve. Ky sistem i monitorimit dhe përmirësimit është një hap i rëndësishëm për garantimin e cilësisë dhe transparencës në procesin akademik. ²⁰⁰

¹⁹⁹ Manuali i cilësisë në UNIKO” Evidenca nr. 1.16

²⁰⁰ Model pyetësori fund kursi/moduli”. Evidenca Nr.2.24

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i Manualit të Cilësisë të UNIKO, rezulton se mënyra e funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë është e përcaktuar qartë, duke u detajuar në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sistemi dhe në "Synimet e Planit të Zhvillimit Strategjik 2022-2027". Departamenti i Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (DKVI) dhe Sektori i Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (SKVIA) janë përgjegjës për koordinimin e punës së Njërive të Sigurimit të Cilësisë në fakultete dhe raportojnë drejtpërdrejt tek autoritetet dhe organet drejtuese të universitetit për masat që duhen ndërmarrë. <i>Në këto struktura janë përfshirë edhe studentët, por një rekomandim i mundshëm është përfshirja e ekspertëve të jashtëm në Njësitë e Sigurimit të Cilësisë të fakulteteve dhe në nivel institucional. Ky hap mund të ndihmojë në rritjen e objektivitetit të procesit të vlerësimit dhe të sjellë një perspektivë të jashtme dhe ekspertizë në përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative të institucionit.²⁰¹</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UNIKO ka implementuar një sistem të plotë vlerësimi të brendshëm dhe të jashtëm për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e tij akademike dhe administrative. Kjo përfshin përdorimin e instrumenteve të përcaktuara në Manualin e Cilësisë, të cilat mundësojnë realizimin e vetvlerësimit të institucionit dhe të programeve të studimit. Përveç vlerësimit të brendshëm, UNIKO është nënshtruar dy herë vlerësimit të jashtëm për akreditimin institucional dhe ka marrë një vlerësim pozitiv për periudhën 2023-2027, me vendimin e fundit të BA Nr. 2 datë 27/01/2023. Aktualisht, institucioni është në proces akreditimi për programet e studimit që ofron. Ky proces është një garanci për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve dhe programeve akademike.²⁰²
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,	Nga takimet e organizuara në institucion për grumbullimin e të dhënave për analizat vjetore të veprimtarisë, është konfirmuar se UNIKO ka një proces të qartë dhe të matshëm të vlerësimit të cilësisë në shkallë njësie bazë, njësie kryesore dhe si institucion në tërësi. Ky proces përfshin përdorimin e instrumenteve të qartë që lidhen me disa aspekte të rëndësishme si procesi mësimor, performanca e stafit akademik, menaxhimi dhe organizimi i brendshëm, mbështetje për studentët dhe veprimtaritë mbështetëse. Ky vlerësim është në përputhje me standardet e

²⁰¹ Raport institucional I vlerësimit të brendshëm të NJSBC në UNIKO" Evidenca nr: 2.19

²⁰² Manuali i cilësisë në UNIKO" Evidenca nr. 1.16



institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	cilësisë të përcaktuara në dokumentet strategjike të UNIKO, dhe mbështetet nga instrumenta që mundësojnë analizën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe rezultateve të arritura. ²⁰³			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ndërtuar një strukturë të plotë dhe ka hartuar rregullore të studimit për të ndjekur sigurimin e cilësisë, por vëren se aktualisht nuk ka ekspertë të jashtëm si pjesë e kësaj structure;</i> <i><u>Rekomandojmë</u> që të përfshihen ekspertë të jashtëm në të gjitha njësitë që merren me sigurimin e cilësisë, për të siguruar një vlerësim të pavarur dhe objektiv, si dhe për të forcuar më tej praktikën dhe proceset e cilësisë në institucion;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë përdorin mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” në shërbim të akreditimit, në përputhje me Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, dhe planin strategjik të institucionit për sigurimin e cilësisë.²⁰⁴ Njësia kryesore organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit nga një komision ad-hoc i ngritur në rang njësie, duke evidentuar probleme dhe sugjeruar zgjidhje. Rezultati i këtij procesi për vitin akademik 2023-2024 ka sjellë një përmirësim të kurrikulës, duke iu përshtatur udhëzimeve të MAS-së.²⁰⁵

²⁰³ Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore FEF, 2023-2024” Evidenca nr: 2.9

²⁰⁴ Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF”.Evidenca nr: 2.1.

²⁰⁵ Praktika e ndryshimeve në kurrikulë” Evidenca nr : 2.17.

vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me vlerësimin e tërë veprimtarisë mësimore shkencore të institucionit dhe njësisë kryesore, si dhe nga takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe stafin akademik, rezulton se raportet vjetore të punës mësimore dhe shkencore të FEF dhe DE përfshijnë tërë aspektet e veprimtarisë mësimore shkencore apo kërkimore, si dhe formimin profesional të studentëve. Raporti evidenton arritjet, por edhe problematikat, bën një analizë të realizimit të objektivave dhe pritshmërive, duke dalë me përfundime dhe sugjerime për të ardhmen.²⁰⁶ <i>Por sugjerohet se në këto raporte duhet të ketë më shumë forma të promovimit dhe motivimit të praktikave të mira, si dhe përcaktimi me një plan konkret pune dhe afate të caktuara për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga vizita në institucion, konfirmohet se UNIKO, në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji të vlerësimit të drejtpërdrejtë, bazuar në Statutin e UNIKO, Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO për periudhën 2022-2027, dhe Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO-së. Vlerësimi i performancës së veprimtarisë akademike lidhur me programin e studimit bazohet në instrumenta të ndryshëm si: analiza krahasuese midis standardeve të paracaktuara në formën e objektivave për sigurimin e cilësisë dhe shkallës së përmbushjes së tyre, orë të hapura leksionesh nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), vlerësim i rezultateve të provimeve, etj.^{207/208/209}

²⁰⁶ Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore De, 2023-2024” Evidenca nr: 2.10

²⁰⁷ Manuali për vlerësimin e performancës së stafit akademik” Evidenca nr: 1.24

²⁰⁸ Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA” Evidenca nr: 2.23.

²⁰⁹ Shembull i orëve të hapura, FEF” Evidenca nr: 2.26

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, konfirmohet se UNIKO, në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta. Kjo përfshin pjesëmarrjen në tryeza të rrumbullakëta për diskutime dhe trajnime që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve me partnerë të huaj, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në Arsimin Parashkollor përmes Alumnit, pjesëmarrje e studentëve në takime pune që organizon DA, me qëllimin për të evidentuar kërkesat apo sugjerimet e tyre, dhe shkëmbimin e informacionit me institucionet bashkëpunuese etj. ^{210/211}			
Konkluzione	Institucioni, përmes njërive përgjegjëse të programit, monitoron përpjekjet që bëhen për realizimin e objektivave të programit dhe përdor metodologji të ndryshme për vlerësimin e performancës së tij, duke përfshirë vlerësimet e drejtpërdrejta dhe tërthorta, si dhe shkëmbimin e informacionit me studentët dhe institucionet bashkëpunuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe	Nga shqyrtimi i Manualit të Sigurimit të Cilësisë të UNIKO dhe nga vizita në institucion, mund të konfirmojmë se për garantimin e procesit të sigurimit të cilësisë, institucioni ka përfshirë të

²¹⁰ Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA" Evidenca nr: 2.23

²¹¹ "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare 2022-2023, UNIKO" Evidenca nr: 2.8



procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	gjitha strukturat e brendshme të tij duke përcaktuar në manual përgjegjësitë si të Senatit Akademik, Njësisë për Sigurimin e Cilësisë (NJSBC), stafin akademik dhe studentët. ²¹² Për përfshirjen e aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të cilësisë, UNIKO ka ngritur edhe "Bordin Këshillimor" me përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me rezultatet e të nxëniet të programeve të studimit, si dhe me çështjet e punësimit të diplomuarve. ²¹³
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se në Statutin e UNIKO-së, si dhe në Manualin e Cilësisë, janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tërë aktorëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të cilësisë në institucion, si të DKVIA (Drejtoria e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional) dhe të NJSBC (Njësia për Sigurimin e Cilësisë) në nivel institucioni dhe njërive pranë fakulteteve. Veprimtaria e këtyre strukturave konsiston në monitorimin e tërë procesit mësimor, me qëllim përmirësimin e treguesve të performancës apo cilësisë së programeve të studimit. ²¹⁴
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga analiza e dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon DKVIA (Drejtoria e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional) dhe NJSBC (Njësia për Sigurimin e Cilësisë) në UNIKO, mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin parashkollor", ka një bashkëpunim efektiv me hallkat e tjera institucionale, njësitë kryesore, njësitë bazë, anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës-akademik, si dhe studentët. Ky bashkëpunim pasqyrohet në diskutimet, opinionet dhe sugjerimet e tyre, si dhe në raportet e analizave vjetore që organizohen në shkallë fakulteti apo institucioni. ²¹⁵
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UNIKO, konstatohet se në aktet rregullatore dhe në Kodin e Etikës të institucionit (nenet 5, 6, 7), janë sanksionuar qartë procedurat për përfshirjen dhe aktivizimin e stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit. Në këto dokumente respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit, përsosmëria dhe liria akademike, si dhe respektohet

²¹² Manuali i Cilësisë së UNIKO" Evidenca nr: 1.16

²¹³ Vendimi për krijimin e bordit këshillimor UNIKO" Evidenca nr: 3.1.

²¹⁴ Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë," Evidenca nr: 1.1.

²¹⁵ "Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm NJSBC, UNIKO, relacion (raporti FEF)"Evidenca nr: 2.19

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	ndërsjelltësia dhe dinjiteti njerëzor, duke siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve. ²¹⁶			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga verifikimi i evidencave të paraqitura gjatë vizitës në institucion, rezulton se UNIKO ka përfshirë në mënyrë aktive Bordin Këshillimor në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë për programin Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Prashkollor". Siç theksuam më sipër, ky bord përfshin përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, si dhe bashkëpunëtorë të përfshirë në realizimin e këtij programi studimi. Për më tepër, institucioni ka ndërtuar një rrjet partnerësh dhe institucioneve brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke siguruar ekspertizë të jashtme për të vlerësuar ecurinë dhe përparimin e programit të studimit. ²¹⁷			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL, konstaton se UNIKO siguron pjesëmarrjen aktive të tërë strukturave të saj dhe nxit përfshirjen e partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera për sigurimin e brëndëshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizita në institucion, konfirmohet se në faqen zyrtare të UNIKO janë të aksesueshme Statuti, Rregullorja e studimit, Plani Strategjik i Zhvillimit 2022-2027, Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e UNIKO, ku janë të pasqyruara menaxhimi institucional në kuadër të sistemit të sigurimit të

²¹⁶ Kodi i Etikës në UNIKO" neni 2;6; 14;16. Evidenca Nr.1.19.)

²¹⁷ "Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale Evidenca_Nr: 3.10

transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	cilësisë, promovimi i një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë.^{218/219} Nga vizita në institucion u konfirmua se NJSBC publikon në faqen zyrtare të UNIKO krahas veprimtarive të planifikuara edhe raportet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. <i>Megjithatë, mendojmë se duhet të pasqyrohen edhe raportet e viteve të fundit, pasi ato aktualisht janë deri në vitin 2021.</i>²²⁰
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga vizita në UNIKO, rezulton se institucioni ka të sanksionuar në Rregulloren e funksionimit dhe organizimit të DKVI-së dhe në Statutin e UNIKO (neni 85 pika 1) detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të institucionit të të gjitha të dhënave dhe rezultateve në kuadër të vlerësimit të programeve të studimit që ajo ofron. <i>Megjithatë, publikimet e këtyre të dhënave duhet të jenë periodike për të siguruar transparencën dhe mundësinë e vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i>²²¹
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shqyrtimi i analizës vjetore të FEF dhe Departamentit të Edukimit, rezulton se procesi i vlerësimit të programeve të studimit, pas relacioneve të dhëna lidhur me rezultatet e vlerësimit, ka objektiva dhe prioritete. Megjithatë, ky proces nuk shoqërohet me një plan masash që ka orientim për përmirësimin e mangësive kur ato janë të konstatuara.²²² <i>Për të përmirësuar këtë proces dhe për të siguruar një ndjekje të vazhdueshme të rezultateve, rekomandojmë hartimin e një plani veprimi masash për programin e studimit, ku të përcaktohen qartë mangësitë dhe dobësitë e konstatuara, dhe të hartohet një plan masash me afate kohore për realizimin e tyre.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve që disponon UNIKO dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, dhe veprimtarive të planifikuara dhe të realizuara nga kjo njësi, konstatojmë se është siguruar ndikimi i këtyre veprimtarive për përmirësimin dhe rritjen cilësore të performancës së pedagogëve dhe studentëve, si dhe për përmirësimin cilësor të programit të studimit. Kjo ka ndihmuar në forcimin e lidhjeve mes institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin mësimor dhe ka kontribuar në zhvillimin e

²¹⁸ Plan i Zhvillimit Strategjik të UNIKO, 2022-2027" Evidenca Nr.1.3

²¹⁹ Faqja zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>

²²⁰ Faqja zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>" (Raporte të sigurimit të brëndëshëm të cilësisë NJSBC.)

²²¹ Statuti i Universitetit Fan.S.Noli. Korce" Evidenca nr: 1.1

²²² Raport I analizës vjetor të veprimtarisë mësimore shkencore të DE" Evidences Nr.2.10

	një kulture të qëndrueshme të cilësisë në të gjitha nivelet e programit. ²²³			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion mund të konfirmojmë se Njësia Kryesore (FEF) dhe Njësia Bazë (DE) ofrojnë informacione të nevojshme tek stafi akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore. Nëpërmjet organizimit të takimeve, bëhet i mundur ndërgjegjësimi i stafit për përmirësimin e treguesve cilësorë të performancës së veprimtarisë akademike dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, duke siguruar një vazhdimësi të punës për përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e strukturave akademike. Kjo nxit një proces të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, që është i orientuar në përmirësimin e vazhdueshëm të rezultateve.			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kritereve 1-5 të standardit VI.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL, konstaton se IAL-ja ka të sanksionuara në strukturat e saj politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e cilësisë, harton raporte, por sugjerojmë se ato duhet të publikohen periodikisht dhe të shoqërohen me një plan veprimi për përmirësimin e mangësive të konstatuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²²³ Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FEF, 2023-2024. .Evidenca_Nr.2.9



Përfundime të Vlerësimit të Programi i Studimit të Ciklit të Parë në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. **Eksperiencia dhe Kualifikimi i Departamentit të Edukimit në UNIKO**, është një eksperiencë e gjatë dhe e konsoliduar në ofrimin e programeve të studimit në fushën e arsimit fillor;
2. **Struktura e Programit**: Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është i strukturuar dhe funksionon sipas Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve nënligjore, i orientuar drejt përmirësimit cilësor në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare;
3. **Njohuri dhe Mundësi për Integrim në Mjedisin Kërkimor**: Ky program ofron njohuri të thelluara dhe mundësi për integrim të studentëve në mjedisin kërkimor shkencor, si në nivelin kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, siguruar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të përbashkëta;
4. **Praktika Profesionale dhe Përshtatja me Kërkesat e Tregut të Punës**: Programi garanton mundësi për përdorimin praktik të njohurive përmes praktikës laboratorike, praktikës profesionale dhe stazheve në bashkëpunim me Bashkitë e rajonit dhe institucione të tjera, duke ndihmuar në lidhjen e mësimit me nevojat e tregut të punës;
5. **Politikat dhe Procedurat për Sigurimin e Cilësisë**: Politikat e ndjekura nga institucionet janë në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet e cilësisë dhe reflektojnë një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e mësimdhënies dhe shërbimeve akademike;
6. **Kultura e Sigurimit të Cilësisë dhe Transparenca**: Institucioni ka zhvilluar një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë, duke siguruar transparencë dhe efektivitet në të gjitha proceset e sigurisë së cilësisë dhe i ka bërë ato publike;
7. **Infrastruktura dhe Mjediset**: Mjediset dhe infrastruktura janë të përshtatshme dhe të mirëpajisura për realizimin e procesit mësimor, duke mbështetur edhe pjesëmarrjen në projekte të financuara nga BE;

b. Pika të dobta:

1. **Përmbajtje e njëjtë në programin mësimor të disa lëndëve të përbashkëta më AF**: Përmbajtja e disa lëndëve të përbashkëta në dy programet AF dhe AP nuk janë të përshatshme me emërtimin apo me objektivat e programit mësimor për nivelin e arsimit parashkollor (*Standarti II.1. Kriteri 2; Standarti II.4. Kriteri 2*);
2. **Mungesa e ambienteve të përshtatshme për lëndët specifike**: Duhet të krijohen ambiente të për lëndët art figurativ dhe muzikor, arti skenik (*Standarti III.4. Kriteri 4*);
3. **Konstatohet se disa nga syllabuset kanë literaturë e cila nuk është e përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me botime të viteve të fundit** (*Standarti II.4. Kriteri 2 dhe kriteri 5; Standarti IV.3 kriteri 1*)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që te disa nga lëndët që janë të përbashkëta me arsimin fillor të jenë më të thelluara me mësimdhenien në arsimin parashkollor;
2. GVJ rekomandon krijimin e ambienteve të posaçme për lëndët art figurativ dhe muzikor, për të përmbushur më mirë formimin praktik dhe profesional të studentëve të programit;
3. GVJ rekomandon përshtatjen e formatit të disa syllabuseve sipas akteve ligjore;
4. GVJ rekomandon të ri-inkuadrohet paketa e praktikës profesionale për ta bërë atë më eficiente dhe me rezultate reale, duke integruar më shumë mundësi praktike për studentët.
5. GVJ rekomandon që raportet e arritjeve duhet të mbështeten mbi analiza SWOT dhe duhet të kenë një strukturë të ngjashme me ato të NJSBC;
6. GVJ rekomandon që zultatet e vlerësimit të shoqërohen me një plan masash të qartë, ku të përcaktohen mangësitë dhe dobësitë dhe të hartohet një plan masash me afate kohore për realizimin e tyre.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in: "Preschool education"**a. Strengths and affirmations:**

1. **Experience and Qualifications of the Education Department at UNIKO**, is a long and consolidated experience in providing study programs in the field of preschool education;
2. **Program Structure**: The Bachelor's study program in "Preschool Education Teaching" is structured and operates in accordance with the Law on Higher Education and its by-laws, oriented toward quality improvement in line with national and international requirements;
3. **Knowledge and Opportunities for Integration into the Research Environment**: This program provides in-depth knowledge and opportunities for student integration into the scientific research environment, both at national and international levels, supported through joint cooperation agreements;
4. **Professional Practice and Alignment with Labor Market Demands**: The program ensures opportunities for the practical application of knowledge through laboratory work, professional internships, and placements in collaboration with regional municipalities and other institutions, supporting the connection between learning and labor market needs;
5. **Quality Assurance Policies and Procedures**: The policies followed by the institution fully comply with the law and quality standards, reflecting a continuous commitment to the improvement of teaching and academic services;



6. **Quality Assurance Culture and Transparency:** The institution has developed a clear policy for ensuring and promoting quality, ensuring transparency and effectiveness in all quality assurance processes, and has made these publicly available;
7. **Infrastructure and Facilities:** The facilities and infrastructure are adequate and well-equipped for the implementation of the teaching process, also supporting participation in EU-funded projects;

b. Weaknesses:

1. **Same content in the curriculum of some subjects common to AP:** The content of some subjects common to both the Primary education and Preschool education programs is not consistent with the name or objectives of the curriculum for the primary education level; (*Standard II.1. Criterion 2; Standard II.4. Criterion 2*)
2. **Lack of suitable facilities for specific subjects:** Facilities should be created for the subjects of fine and musical arts; (*Standard III.4. Criterion 4*)
3. It is noted that some of the syllabuses is not continuously updated with publications from recent years; (*Standard II.4. Criterion 2 and criterion 5; Standard IV.3 criterion 1*)

Recommendation

1. The External evaluation group recommends that some of the subjects that are common to preschool education be more in-depth with teaching in preschool education;
2. The External evaluation group recommends creating special facilities for the subjects of fine and musical arts, to better fulfill the practical and professional training of the program's students;
3. The External evaluation group recommends adapting the format of some syllabuses according to legal acts;
4. The External evaluation group recommends the professional practice component should be restructured to make it more efficient and produce real results, by integrating more practical opportunities for students.
5. The External evaluation group recommends that the Achievement Reports should be based on SWOT analyses and should have a similar structure to those of the Internal quality assurance unit;
6. The External evaluation group recommends that the results of the assessment be accompanied by a clear action plan, identifying deficiencies and weaknesses and drafting a plan of measures with deadlines for their implementation;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

